



Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.11.2019, Ora 14.00

Drejtojnë mbledhjen:

Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore

Rendi i ditës:

Diskutimi i draftit të përpunuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore me përfaqësues të subjekteve politike dhe shoqërisë civile

Marrin pjesë:

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Nimet Musaj, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Korab Lita.

Të ftuar:

Illir Çekiri – Partia Socialiste e Moderuar

Myrnid Guri – Partia Socialiste e Moderuar

Valentino Mustaka – kryetari i partisë ABDE (Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane)

Ilia Gjoka – këshilltar i partisë ABDE

Oltion kordha – kryetar Partia Shqiperia e Re

Ermal Arapi – Aleanca Arbnore Kombetare

Gjergj Prifti – kryetari i LIBRA

Eduard Abazi – përfaqësues i Partisë Aleanca Demokratike

Zef Bushati – përfaqësues i Partisë Aleanca Demokristiane

Kastriot Ahmataj – përfaqësues i Partisë Aleanca Demokristiane

Kujtim Muça – kryetar i Partisë për Integrim dhe Prosperitet

Koço Kokëdhima – kryetar i Zgjidhja

Artur Rozhani – përfaqësues i Zgjidhja

Nik Nekaj – përfaqësues i Partisë së Personave me Aftësi të Kufizuara

Premto Gogo – KRIIK

Kristaq Kume – Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve

Rezart Prifti – përfaqësues të “Alternativa”

Besart Kadia– përfaqësues të “Alternativa”

Aldo Merkoci – Lëvizja MJAFT

Endri Shabani – Nisma Thurje

Panajot Soko – Nisma Thurje

Besjan Pasha – Nisma Thurje

Gerta Meta – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Gazmend Agaj – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Rigers Bena – Shoqata per Kulture Demokratike (SHKD)

Edlira Cepani – Rrjeti i Grave - Barazi në Vendimmarrje Women's Network Equality

in Decision Making

Aranita Brahaj – Albanian Institute of Science AIS

Avokati Mirilla Kondakciu – përfaqëson z. Plarent Aleksi

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjoknuri - Mirë se keni ardhur në këtë mbledhje të Komisionit për Reformën Zgjedhore!

Siç është bërë me dije nga administrata e Kuvendit, nga sekretaria e komisionit, kjo seancë ka për qëllim dëgjimin e opinionit të aktorëve dhe të shoqërisë civile të interesuar në lidhje me propozimet që janë paraqitur në këtë komision, pasi pas shqyrtimit të seancës me dyer të mbyllura për shkaqe që kanë të bëjnë me ecurinë e punës, ne vendosëm që draft i paraqitur nga ekspertët, i cili është i pari, paketë tashmë është bërë publike, të dëgjohen edhe komentet e aktorëve të shoqërisë civile apo persona të tjerë të interesuar, që janë njoftuar zyrtarisht. Kjo do të thotë se biseda duhet të kufizohet dhe të fokusohet vetëm në këtë temë.

Nëse folësit do të dalin jashtë temës, jam i detyruar t'ua ndërpres fjalën. Kjo nuk do të thotë se nuk do të keni mundësi tjetër për të folur për çështje të tjera të reformës zgjedhore, por kur të vijë momenti i duhur. Po e deklaroj seanca tjetër e Komisionit për Reformën Zgjedhore do të fokusohet te çështjet e administrimit, reformimi tërësor i administratës zgjedhore, ku ekspertët do të paraqesin propozimet e tyre në komision. Do të zhvillohet një seancë diskutimi. Më pas do të bëhet përsëri seancë publike pasi ju të keni marrë draftet për të dhënë komentet tuaja. Disa nga organizatat dhe aktorët i kanë sjellë komentet me shkrim, sekretaria i ka administruar dhe komisioni natyrshëm do t'i marrë në shqyrtim përpara miratimit të çdo dispozite përkatëse, por për qëllime të transparencës së publikut dhe njëkohësisht për të gjithë shqiptarët, të huajt apo për cilindo të interesuar që ndjek ecurinë e kësaj reforme menduam të kemi disa seanca publike, gjithmonë në frymën e transparencës dhe të interesit për përfshirjen e gjerë të publikut.

Këto drafte u kanë shkuar edhe partive opozitare që janë jashtë Kuvendit. Ata nuk kanë sjellë opinionet e tyre me shkrim. Siç e kemi thënë, po e përsëris: janë të mirëpritur të sjellin komentet, propozimet e tyre, të cilat komisioni do t'i shqyrtojë njëjloj sikur të jenë anëtarë të këtij komisioni. Pra, do të kërkoja që me radhë jo më shumë sesa 5 minuta të fokusoheni në draftet që janë paraqitur.

Më falni që po e përsëris, por kujtdo që del jashtë temës, jam i detyruar që t'ia ndërpres fjalën, sepse komisioni ka një rend dite të caktuar, do një rregull për të ecur

përpara. Kjo nuk është seancë parlamenti, diskutim i lirë, ku secili merr fjalën dhe jep opinione të ndryshme politike. Ka një listë të përcaktuar folësisht? Ka kërkesë me shkrim?

Fillojmë me shoqërinë civile, po i marr me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari - Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Të nderuar kolegë të Komisionit për Reformën Zgjedhore,

Të nderuar pjesëmarrës të shoqërisë civile, si edhe aktorë politikë që keni ardhur sot në këtë takim. Jemi të lumtur që ju e keni ndjekur procesin e reformës zgjedhore. Jemi të lumtur që merrni pjesë në këtë takim. Jemi të hapur të dëgjojmë opinionet tuaja lidhur me draftin e parë të ekspertëve. Ju garantojmë se rekomandimet tuaja do të merren parasysh nga komisioni. Nga eksperiencat e para, në komisionet e mëparshme nuk ka pasur vullnet politik nga të dyja partitë kryesore që t'u merren parasysh opinionit apo vlerësimet që keni pasur për reformën zgjedhore, por në këtë komision ju garantoj se do të ndihet edhe zëri juaj.

Konstatoj se shumë prej aktorëve civilë nuk janë këtu. Unë i kam marrë rekomandimet e tyre. Ju garantoj se produkti i punës së këtij komisioni do të bazohet fort në angazhimin e të gjithë aktorëve politikë, civilë që kanë dëshirë të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre në proceset e reformës zgjedhore.

Përfitoj nga rasti t'i nxis të gjithë aktorët që janë këtu, por edhe ata që janë jashtë parlamentit të vazhdojnë të japin kontributin e tyre, të depozitojnë propozimet e tyre dhe ne do t'i marrim parasysh nën frymën e transparencës dhe të gjithëpërfshirjes që ka si synim ky komision.

Dua t'ju them dhe t'ju komunikoj një fakt, e them me keqardhje, pasi shikoj shumë njerëz që nuk kanë ardhur sot në takim, pasi lexova rekomandimet që kanë dhënë këta aktorë në lidhje me draftin e parë të ekspertëve, evidentova se ka goxha problematika në këtë draft për karakterin e tij sipërfaqësor në lidhje me trajtimin e rekomandimeve të ODIHR-it. Në këtë aspekt mendoj se roli juaj është shumë i rëndësishëm, sepse do të jeni ju ata që do të thoni se si mund ta përmirësojmë draftin e ekspertëve, në mënyrë që të kemi një reformë zgjedhore me integritet të plotë, me përvojë që duhet të jetë thellësisht demokratike, institucionale dhe pastaj do të marrë trajtën ligjore në parlament.

Prandaj dua t'ju them harrojeni se ky komision do të jetë thjesht një komision, i cili do të konsiderojë në mënyrë sipërfaqësore disa korrektive të pjesshme të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Ne do të bëjmë një reformë zgjedhore, e cila është gjithëpërfshirëse,

por ka për synim disa nga vizionet tona si opozitë në parlament. Dua të theksoj këtu se 3 janë vizionet, pikat kryesore ku ne bazohemi fort dhe duhet që procesi zgjedhor t'i përgjigjet siç janë:

1. Qytetari shqiptar të jetë ai që të vendosë në zgjedhjet e përfaqësimit politik.
2. Hapja e partive politike që të kenë konstituim më demokratik brenda tyre.
3. Krijimi i hapësirave dhe i lehtësirave për nxitjen e alternativave të reja në Shqipëri.

Besoj se këto objektiva udhëhiqen shumë edhe nga aspiratat tona kushtetuese që në thelb duhet të mbetet dhe duhet të jenë gjithmonë liria dhe barazia e votës. Në kushtet që jetojmë sot mendoj se ne duhet të kemi më tepër hapësirë për alternativa të reja, t'u japim shqiptarëve alternativa që të votojnë dhe jo të jenë 2-3 parti, të cilat të dominojnë tregun e votës.

Pa e zgjatur ftoj shoqërinë civile të na sjellë vlerësimin e saj konkret për draftin e parë të ekspertëve.

Faleminderit për vëmendjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjijnuri - Thamë që do të flasin përfaqësues nga shoqëria civile. Zotëri, nuk je anëtar.

Ti ke konflikt interesi me logjikën. Dilni jashtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë procedure kërkon?

Rudina Hjadari - Zoti Gjuzi, ju lutem nuk duhet të ndërhyni!

Sot do të flasin përfaqësues të shoqërisë civile.

(Zoti Gjuzi flet pa mikrofon)

Damian Gjijnuri - Ju lutem!

Edhe një herë pavarësisht nga emocionet e larta, fokusohuni te drafti që kemi paraqitur.

Ka një listë të folësve? Po i marrim me radhë.

Fjalën e ka Premto Gogo i KRIIK-ut. Ju lutem 5 minuta!

Lirojani pak vendin, sepse këto janë mundësitë fizike të kësaj sale. Do të fillojmë me shoqërinë civile dhe pastaj me partitë politike.

Ju kërkoj ndjesë!

Do të marrim kohën e nevojshme.

Rudina Hjadari - Zoti Gogo fjala është për ju.

Premto Gogo - Faleminderit!

Quhem Premto Gogo dhe përfaqësoj “KRIIK Albania”, është një organizatë, e cila i ka ndjekur së paku 4 proceset e fundit reformuese të ligjit elektoral që nga viti 2012, më parë edhe në kuadër të koalicionit të vëzhguesve vendorë.

Më duhet t’ju përgëzoj për mundësinë e parë pas konstituimit të komisionit të ri për dorën e shtrirë ndaj shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë joparlamentarë qoftë politikë, qoftë civilë.

Më duhet që përveçse t’u përgëzoj për draftin e parë me një gjë konkrete nga pikëpamja e tematikave të prekura, por për sa i përket asaj që është më thelbësore, pjesën e kontekstit në të cilën ky komision po zhvillon punën e tij. Në vazhdimësi edhe të një shkresë që ju kemi dërguar në përgjigje të kërkesës suaj për opinion, më duhet të tërheq vëmendjen në emër të KRIIK-ut për mangësi në transparencë dhe në elementet gjithëpërfshirëse të procesit.

Më lejoni të them zotërinj bashkëkryetarë se ky është një hap mbrapa në krahasim me dy proceset e fundit të reformës zgjedhore të drejtuara nga zoti Balla, zoti Çuçi dhe zoti Bylykbashi dhe na çon në vitin 2012 atëherë kur po ju e drejtonit komisionin e atëhershëm bashkë me zotin Rusmali. Kjo nuk sjell asgjë të mirë në momentin kur ne duam që ky proces duhet të legjitimojë dhe të nxisë besimin e qytetarëve. Ky produkt që do të dalë nga komisioni, në gjykimin tonë do të jetë produkti mbi bazën e të cilit do të kemi edhe nisjen apo kompromisin politik për zgjidhjen e krizës politike. Nga kjo pikëpamje ne duhet t’i shikojmë në qasje vizionari të gjitha problematikat e prekura dhe jo thjesht një qasje e ngushtë partiake, individuale dhe për më tepër në një proces totalisht të mbyllur. Kjo është jo thjesht një qasje politike jona, por është një qasje zyrtare, pasi ne u jemi drejtuar juve si komision Kuvendit që në qershor dhe gjatë tetorit për të pasur kopje të vendimmarrjeve, të planit të punës, për të pasur zbardhje të procesverbaleve e të tjera në mënyrë që të bëhemi pjesë e gjësë.

Le të shpresojmë që ky të jetë momenti i parë për një bashkëpunim në vazhdimësi, pasi nuk mendoj se mbledhja e mbyllur i ndihmon çështjet, sepse në momentin kur kemi një shtrat parimor, ideor nuk ka asgjë që këtu të jetë e përfshirë edhe ekspertiza e aktorëve jopolitikë. Mund të ketë një farë rezerve ndaj medias, por jo për ekspertizën, të cilën tashmë e kanë sidomos organizatat e shoqërisë civile.

Ne kemi propozuar edhe më parë për mënyrën e funksionimit të komisionit, që të rregullojë këtë specifikë, sepse Rregullorja e Kuvendit nuk e rregullon dhe nuk është efikase për të bërë këtë komunikim të ndërsjellë, dinamik midis jush si anëtarë komisioni,

faktorëve të tjerë politikë brenda dhe jashtë parlamentit, faktorëve të tjerë të shoqërisë civile apo ekspertë që vijnë nga bota akademike.

Nëse do të kalonim në draftin e parë, në një vlerësim të përgjithshëm është ajo që sapo thashë, ju keni prekur disa tematika, por në gjykimin tonë ato janë prekur përciptazi, nuk ka një qasje thelbësore mbi to, nuk ka një qasje integrale mbi to, nuk ka një qasje vizionare mbi to, që t'i japë drejtim amendimeve, që të mos ngelemi te arnimet e zakonshme, por të kemi një qasje të thelluar e thelbësore të çështjeve, një qasje integrale të ligjit zgjedhor.

Në gjykimin tonë, veçanërisht në lidhje me procesin e 30 qershorit, kemi evidentuar se, qoftë pjesa e Kodit Zgjedhor, miratuar në 2008-ën, me precedentët e krijuar, qoftë sjellja institucionale, kanë zhbërë funksionalitetin e plotë të Kodit dhe atë të KQZ-së. Në momentin që nuk gjen konvertimin e interesave apo vizioneve të saj, politika ia kalon pa të drejtë këtë patate të nxehtë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e më pas presioni politik nxit pandëshkueshmërinë, moszbatueshmërinë e ligjit apo sjelljet joinstitucionale.

Mund të bëjmë vetëm tre vlerësime lidhur me draftin.

E para është kjo që i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që i jepen tagra pa marrë në konsideratë kapacitetin e tyre real njerëzor, një institucion që vazhdon të rëndohet me detyra, ndërkohë që misioni është i dështua. Tashmë i japim edhe pjesën e kontrollit të veprimtarive publiket institucioneve qendrore, gjë që krijon edhe probleme në strukturë, në lidhje me faktin se çfarë tagrash do të ketë ndaj institucioneve, titullarëve të institucioneve e të tjera.

Gjëja tjetër ka të bëjë me pjesën harmonizuese, që i mungon draftit të parë, përfshirja e të tretëve në proces. Është një precedent shumë pozitiv, që udhëzimet e miratuara këtë prill nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me denoncimin e elementëve jo korrekt financiarë, ju e keni futur edhe këtu. Ka qenë një rekomandim i hershëm i OSBE/ODIHR-it, por ju e keni futur si ata që duhet të bëjnë vëzhgimin paralel të abuzimeve, gjëra në të cilat kanë dështuar edhe forcat politike të opozitës. Ne gjykojmë se ky është një delegitimim i zërave të pavarur të shoqërisë civile dhe nuk mendojmë se do të jetë diçka efikase.

Më thelbësorja është tema që ne e konsiderojmë më prioritare. Në kontekstin e një krize të fortë politike, moszbatueshmërisë së ligjit, institucioneve të dobëta, të një korrupsioni galopant, të një prezence shqetësuese të krimit të organizuar, merr peshë dhe domosdoshmëri prioritare adresimi i financimit jo thjesht të fushatave zgjedhore, por të partive politike, dhe absolutisht i fenomenit të korrupsionit zgjedhor, që në këtë draft shikojmë se është diçka joserioze, për të mos përdorur një fjalë tjetër joetike.

Nuk mundet që me një angazhim ceremonial të kryetarëve të partive, për më tepër në absurdin e vet, me një tekst të hartuar nga KQZ-ja, të adresohet ky problem kaq madhor për shoqërinë tonë.

Ju faleminderit, zoti kryetar! Menduam se këto janë më të rëndësishme se sa elementët e detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Pra, ju u fokusuat te vlerësimi politik, si dhe bëtë qasjen tuaj në lidhje me atë çka do të prekë reforma zgjedhore. Kjo është në të drejtën tuaj. Megjithatë, ne i kemi marrë komentet me shkrim. Unë mendoj se ju dhe shumë të tjerë, jeni në gjendje të bëni propozime konkrete sa u përket neneve që preken, si dhe duke pasur në mendje shqetësimet që përmendët.

Megjithatë, kjo është zgjedhja juaj. Materiali ka ardhur dhe do të studiohet nga komisioni.

Ju faleminderit shumë!

Kalojmë te folësi tjetër, përfaqësuesi tjetër i radhës, zoti Afrim Krasniqi, ISP-ja.

Ka përfaqësues?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Afrim Krasniqi, jeni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë? Instituti i Studimeve Politike. Nuk është.

Kalojmë te zoti Erjon Tase, nga Akademia e Studimeve Politike. Ka ardhur Erjon Tase? Nuk është as Erjoni.

Kalojmë te zoti Kristaq Kume, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Për procedurë flasin vetëm anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Procedura është dakordësuar. Janë ftuar përfaqësuesit e shoqërisë civile. Si për çdo projektligj tjetër, do të jepni mendimet dhe vlerësimet tuaja. Ky është rregulli bazë i çdo komisioni, i çdo institucioni që bën konsultime. Tashti, të mos e kthejmë në pazar politik, meqenëse janë përfaqësuesit, dhe o burra të marrim fjalën.

Pra, me radhë. Të gjithë të ftuarve do t'u jepet fjala, brenda një afati prej pesë minutash, sepse aq na mundëson koha që kemi. Propozimet janë sjellë me shkrim, drafti është bërë publik dhe është dërguar zyrtarisht. Të drejtën për të folur këtu, e kanë vetëm anëtarët e komisionit. Në këtë rast, anëtarët e komisionit nuk kanë pse të ndërhyjnë, sepse me

marrëveshje kemi rënë dakord që do t'ju dëgjojmë juve, ndërsa më pas, në një seancë tjetër, ne do të bëjmë diskutimet tona në lidhje me propozimet.

Kësisoj, le të vazhdojmë me folësin e radhës.

Faleminderit!

Kristaq Kume – Të nderuar anëtarë të komisionit,

Të nderuar pjesëmarrës, përfaqësues të partive politike dhe kolegë të shoqërisë civile,

E para gjë, që do të doja të theksoja në këtë takim, ka të bëjë me faktin se ne të gjithë, si shoqëri, jemi në kohën kur duhet të adoptojmë një qasje tjetër ndaj gjithë kësaj pune, kësaj përgjegjësie, kësaj detyre, që duhet të realizojmë në funksion të vetes sonë, mbi të gjitha.

Në bazën e saj, kjo qasje duhet të ketë parimin se reforma zgjedhore, legjislativi zgjedhor nuk hartohet dhe nuk bëhet për të qenë pronë e partive politike. Shpeshherë lakohet kjo gjë. Thuhet se është një kuadër ligjor që na takon neve, por harrojnë se, sa ç'janë të rëndësishëm këto subjekte të shoqërisë sonë, pra partitë politike, në lidhje me mirëhartimin e rregullave për zhvillimin e një procesit zgjedhor, po kaq të rëndësishëm, e mbase edhe pak më shumë se ato, janë shtetasit, janë votuesit shqiptarë, janë ata që nëpërmjet këtyre rregullave arrijnë të transmetojnë vullnetin e tyre në mandate për institucionet që kërkohet të qeverisen.

Kjo do të thotë se ky proces nuk duhet të zhvillohet vetëm si përgjegjësi dhe si punë e një pale, e klasës politike, por si përgjegjësi dhe si punë e përbashkët e ne të gjithëve. Kësisoj, në vlerësimin tim, është e nevojshme të kapërcehen format dhe mënyrat e derisotme e të punuarit, edhe unë vetë jam pjesë e kësaj mënyre pune, që nga viti 2005, me përfaqësues politikë që thërriten, dëgjojnë, u kërkohet të shprehen edhe me shkrim, e pastaj thuhet se u bë detyra.

Jo, të nderuar kolegë, nuk është se ne thërritemi për t'u dëgjuar dhe vetëm për të krijuar mundësinë të thuhet se reforma ishte gjithëpërfshirëse. Unë mendoj se është koha kur ia vlen, që të bashkohemi të gjithë, duke synuar një qasje tjetër, ku të gjithë jemi të barabartë e me të njëjtën fuqi, jo vetëm si fuqi propozuese, por edhe vendimmarrëse, deri në nivelin e draftimit të gjësë. Se pastaj është institucioni ai që e përfundon.

Së dyti, do t'i kthehem faktit që kemi filluar të punojmë së bashku. Instituti që unë drejtoj i ka depozituar pranë jush mendimet e tij, të nderuar kolegë të komisionit, në lidhje me çfarë dhe si është bërë e mundur që në këtë draft të pasqyrohen rekomandimet e dhëna nga OSBE/ODIHR-i.

Unë nuk do t'i marrë të gjitha një e nga një, por midis të tjerave, për mua do të ishte shumë e rëndësishme që ju të rikonsideroni rekomandimin e dhënë nga misioni i vëzhguesve

ndërkombëtarë, që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve institucionale, të cilat do të mundësojnë monitorimin në kohë reale dhe auditimin e financimeve e shpenzimeve në fushatat zgjedhore. Të paktën në këtë draft që kemi, por edhe në atë çka unë propozoj se mund të realizohet në përmirësimin e mëtejshëm të asaj që kanë paraqitur teknikët në të, nuk është se mund të arrihet të shkohet deri në realizimin e plotë të këtij rekomandimi. Megjithatë, për t'iu përafuar sa më shumë, ajo çfarë ne kemi propozuar këtu, është që krahas kushtëzimit ligjor, i cili e detyron Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por po ashtu i jep të drejtën të angazhojë e më pas të konsiderojë se çfarë prodhojnë auditet ose monitoruesit në kohë reale, së bashku me këta të ketë edhe monitorues nga shoqëria civile, monitorues të pavarur, që do të thotë se duhet të fillohet nga puna për të krijuar atë që quhet platformë gjithëpërfshirëse, edhe si prodhuese e një informacioni më të saktë për atë çfarë ndodh me financimin dhe përdorimin e financave në fushatat zgjedhore, por edhe si presion. Në dokumentin që kam paraqitur, ajo është shkruar në trajtën e një draft-dispozite, ndër vëzhguesit e pavarur të krijohet një grupim i tillë vëzhguesish, të cilët do të jenë monitorues në kohë reale të financave të partive politike.

Po ashtu, është e nevojshme të rikonsiderohen problemet që kanë të bëjnë me faktin se, duke lexuar draftin, të krijohet përshtypja se kjo më shumë është deklarative se funksionale. Nuk dua t'i marr një nga një, por i gjithë materiali që unë kam dorëzuar është në dispozicionin tuaj, dhe jeni ju që do të merrni vendimin nëse mund t'i konsideroni apo jo.

E dyta që ka rëndësi të konsiderohet nga ju dhe partitë politike, se në të vërtetë ata bëjnë rregullin këtu tek ne, ka të bëjë me faktin se opozita jashtë parlamentit, opozita e bashkuar jashtëparlamentare, e cila është deklaruar si e tillë, në kuadër të plotësimit të detyrave që ne kemi për të mirërregulluar legjislacionin zgjedhor, po punon edhe ajo.

Ju, ose Kuvendi i Shqipërisë, i ka krijuar mundësinë institucionale, me vendin që i ofron në cilësinë e vëzhguesit me të drejtë vetoje, që ajo t'i shprehë këtu të gjitha ato çfarë dëshiron dhe si i mendon. Me sa duket, një qasje e tillë, sado e vlerësuar të jetë, është e papranuar prej tyre.

Në këto kushte, nuk duhet të themi se ne e kemi mbaruar punën me ta, po të duan të vijjnë, ja ku e kanë karrigen, po të duan të mos vijjnë. Kjo është zgjidhje zero, jofunksionale. Është e domosdoshme të punohet për gjetjen e një zgjidhjeje, e cila të përafrojë palët. E që të përafrohen palët politike, që deri më tani vetëm divergojnë, duhet lakmushi, duhet një i tretë, dhe i treti jemi ne, qytetarët, që mund t'ju bëjmë juve bashkë, që të afroheni.

Në të kundërt, ajo çfarë bëhet në lidhje me këtë gjë, nesër kur për një arsye apo për një tjetër, palët mund të bien dakord të afrohen, të bëhet marrëveshje. S'ka pse të befasohemi,

s'ka pse të mos e konsiderojmë mundësinë e një marrëveshjeje nesër. Çdo gjë që është shkruar këtu, gjithçka që ju do të bëni, mund të zerohet, sepse, të paktën me sa kam informacion unë, opozita e bashkuar është duke draftuar rregulla totalisht të ndryshme, me një koncept totalisht të ndryshëm, me një parim totalisht të ndryshëm nga ai tek i cili është mbështetur hartimi i kësaj gjëje këtu.

Kësisoj, të mos shpenzojmë energji kot, por le të shpenzojmë energjitë e nevojshme për t'u bërë bashkë, me qëllim që të prodhojmë një produkt të përbashkët, i cili, si i tillë, në nivel drafti, të miratohet nga ju, nga Kuvendi i Shqipërisë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Po, zoti Myslim!

Myslim Murrizi – Faleminderit të dy kryetarëve, edhe zotit Kume, edhe parafolësit të tij. Unë si anëtar i komisionit do të doja nga ju një opinion më të drejtpërdrejtë. Detajet teknike të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it i kemi këtu që prej dy vjetësh. I kanë pasur ata që kanë qenë para nesh. Nuk e di pse i kanë mbajtur. I kemi ne, nuk kemi divergjenca për atë punë. Ai për të cilin ne, krahu këtej, kemi probleme dhe divergjenca dhe që realisht kam interes të dëgjoj krahun tuaj (që kjo të mos mbetej midis 2 apo 3 krahëve, edhe atyre që janë jashtë, por të jetë midis gjithë atyre që mendojnë se përfaqësojnë një grup shoqëror social apo një komunitet të caktuar shqiptarësh), është sistemi zgjedhor.

Zotërinj, na flisni shkurt! Lërinj detajet teknike!

A mendoni ju që ky Kod Zgjedhor është i duhuri për qytetarët shqiptarë? Shkurt! Unë për këtë kam ardhur t'ju dëgjoj. Kush ka qejf të mbushë orë pune dhe të dëgjojë se çfarë na kanë thënë me plot libra “*Antiduring*”-u i Marksit dhe OSBE-ja... Nuk kam fare interes për atë punë!

Ju, zotërinj, e doni apo jo këtë sistem zgjedhor? Kam qejf t'ju dëgjoj ju. Unë për vete nuk e dua. Desha të jeni më të qartë. Llafet i merr era.

A është ky sistemi zgjedhor që e ka futur këtë vend në kolaps apo jo, që e ka stisur këtë krizë politike artificiale, që ka rritur autokracinë edhe në qeveri, edhe në opozitë? Këto dua të dëgjoj nga ju. Unë për vete jam i qartë. Do të luftoj fort për ta prishur këtë sistem zgjedhor.

Me çfarë do të na ndihmoni ju? Nëse edhe ju jeni dakord që ky sistem zgjedhor të qëndrojë, kot jemi mbledhur këtu!

Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – ...dakord që e bëtë pyetjen, por të lutem, të jetë ndërhyrja e fundit e kësaj natyre, për arsyen se thamë që do të flasim për draftet që kemi! Për sistemin zgjedhor secili mund të japë opinionin e vet. I kanë sjellë edhe me shkrim.

Kur të vija dita të kemi një draft për sistemin zgjedhor, që përfaqësuesit e nderuar këtu e kanë marrë përsipër si iniciatorë, ku patjetër edhe ne si Parti Socialiste kemi komentet dhe propozimet tona (se edhe ne kemi propozimet tona për sistemin zgjedhor, nuk jemi të paineduar), atëherë do të merremi seriozisht me të. Kështu që le të fokusohemi te draftet.

Megjithatë, meqenëse zoti Murrizi bëri një pyetje, ju mund të jepni një opinion, por dua të jetë i fundit për këtë temë.

Kristaq Kume – Faleminderit!

Së pari, më duhet të them se kam ardhur këtu prej ftesës që ju keni dërguar për vazhdimin e punës së kërkuar dhe kontributit që duam të japim. Kjo do të thotë t'i përgjigjemi fjalë për fjalë (për të qenë racionalë) asaj për të cilën na kanë kërkuar të shprehemi, për mënyrën se si ju keni draftuar Kodin Zgjedhor, për të pasqyruar në të çështjet që kanë të bëjnë me financimin dhe me barazinë gjinore.

Në këtë kuadër, u ula këtu për t'i dhënë përgjigje kësaj gjëje, jo në detaje, sepse i keni te depozituara me detaje këto, madje jo me konsiderata, por duke i formuluar si draftdispozita, se si mund të shtohen dhe si mund të shkruhen deri në këtë nivel.

Prandaj, nuk ia vlen të flas më shumë për këtë gjë. Materialin e keni të shkruar.

Për sa i takon problemit, që për mua nuk është i vogël (gjej rastin të shpreh pse do të ishte më mirë të trajtohej pikërisht ky problem që thatë), të ndryshimit në sistem, në qoftë se biem dakord, jo vetëm ju, politika, por të gjithë ne, mund të afektojë shumë mirë këto që po shkruajmë sot ne, edhe financimin... Pra, do të na duhet të rifillojmë punën. Jemi në kushtet kur për një arsye a për një tjetër (mua nuk më duhet fare dhe as nuk mund të merrem me trajtimin e kësaj gjëje në këtë tavolinë të nderuar, sepse ka vende të tjera ku mund të jap konsideratat e mia), me apo pa dashje, jemi duke ecur në një rrugë, e cila mund të sjellë produkte, por mund të vërë në dyshim produktet që do të marrim. Pra, ndoshta është koha të gjejmë një qasje tjetër, në 2 nivele: në nivelin e parë, kush, si dhe me kë duhet ta bëjmë të gjithë këtë gjë dhe në nivelin e dytë, çfarë dhe nga duhet ta fillojmë këtë gjë.

Në opinionin tim them se është e nevojshme të rikonsiderohet një gjë e tillë. Nuk jam unë ai që marr vendimin për këtë gjë, por mendoj se është e nevojshme të rikonsiderohet, qoftë qasja dhe vendimmarrja juaj në Kuvend, që do ta trajtojnë problemin e reformës zgjedhore kësaj radhe me dy faza dhe të duket sikur është vënë bualli para qerres ose qerrja para buallit... Në qoftë se do të binim dakord...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është vendimmarrja juaj. Në qoftë se do të biem dakord dhe do të ndërronim sistemin, në qoftë se nesër do të bini dakord të konsideroni se çfarë mendimesh ka dhe çfarë propozimesh ka opozita jashtëparlamentare, do të duhet ta rifillojmë punën. Ky është merakun im.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri - ...ekspert i vjetër i zgjedhjeve dhe njohës i mirë i rekomandimeve të ODIHR-it.

A e adreson siç duhet çështjen e barazisë gjinore propozimi që kanë sjellë ekspertët dhe që është diskutuar këtu në komision?

Kristaq Kume – Në një pjesë të mirë po. Është përpjekur të gjejë zgjidhje për ta mundësuar këtë gjë, por në qoftë se nesër do të binim dakord dhe do të kalonim në një sistem tjetër, për shembull, në një sistem proporcional të pastër, do t'ju duhet të rikonsideroni rrugën se si do ta zgjidhni këtë gjë.

Damian Gjikhuri -Të mos bëjmë ekuacione me shumë të panjohura, se kjo dihet. Së pari, ne po diskutojmë për ato që kemi. Nëse do të ketë një ndryshim të sistemit zgjedhor, natyrshëm që këto do të rishikohen, por sot do të flasim për këtë draft dhe për këtë pikë ku jemi, që nuk është përfundimtare, se nuk do të shikojë të miratohet në Kuvend.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Zoti Kume, në vijim të asaj që thatë dhe që e prekët me shumë të drejtë, një nga shqetësimet e mia si anëtar i komisionit, edhe gjatë mbledhjes së kaluar me anëtarët e tjerë, me kolegët e këtij komisioni...

Myslim, për atë po flas.

Një nga shqetësimet tona, si anëtarë të opozitës në këtë komision ka qenë që do të kalojmë shumë kohë me adresimin e disa rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it në draftimin dhe në futjen e ndryshimeve të nevojshme në kod, ndërkohë që shumë prej këtyre neneve bien ndesh me një ndryshim eventual të sistemit ose ndoshta me hapjen e listave.

Unë kam një pyetje për ju. Këtë pyetje ua bëra edhe ekspertëve të kontraktuar brenda komisionit, por duke qenë se jeni këtu dhe e vlerësoj mendimin tuaj, a mendoni ju, zoti Kume, nëse eventalisht shkohet në një përjasje të përbashkët me maxhorancën (le të mos themi në një ndryshim total të sistemit, por të shkojmë deri te hapja e listave elektorale) se këto nene që ne kemi reflektuar në këtë draft zhbëhen?

Nëse këto miratohen në parim, pa u ndryshuar sistemi dhe pa u hapur listat, çfarë efektesh do të ketë në punën e vazhdueshme të komisionit?

Ju falënderoj!

(Diskutime pa mikrofon)

Damian Gjijnuri – Zoti Gjoni, ju lutem! Këtë pyetje e ke bërë edhe me ekspertët dhe ata kanë dhënë një përgjigje. Nëse do të kemi një sistem të ri zgjedhor (se duhet ta ndani mendjen çfarë kërkoni) këto dispozita do të rishikohen prapë. Ne kemi marrë një vendim: nuk do të çojmë asgjë në Kuvend pa e diskutuar këtu me njëri-tjetrin. Kështu që nuk ka nevojë... Kjo është jashtë teme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë te folësi i radhës, që të mos kthehemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, përgjigju me një fjali, të lutem!

Kristaq Kume – Mënyrën se si është zgjidhur çështja gjinore në draftin e teknikienëve, e gjej në përputhje me rekomandimet e dhëna nga OSBE/ODIHR-i. Është zgjidhje që, në kushtet ku jemi dhe me këtë sistem që kemi, ka më të mirat e mundshme. Ndaj, po ta vini re, në materialin që ju kam dorëzuar, nuk e kam trajtuar këtë çështje, sepse më është dukur e pavend për të shtuar më tej, por kam trajtuar vetëm çështje që kanë të bëjnë me financimin e fushatës zgjedhore.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zoti Kume, kam edhe një pyetje të fundit, nëse mundem.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, mbani pak qetësi!

E rëndësishme është të kenë mundësi të flasin të gjithë. Caktuam shoqërinë civile në fillim dhe pastaj do të flasin aktorët politikë. Do të kemi kohë. Besoj se e rëndësishme është t'u japim mundësinë të gjithëve të marrin pjesë dhe të japin opinionet e tyre.

Unë kisha vetëm një pyetje të fundit, zoti Kume, në lidhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, me pikën 2 dhe 3, që janë quajtur si pikat më të rëndësishme të raportit të 2017-s.

A mendoni ju se këto dy pika janë të trajtuara në këtë draft të parë, sidomos kur flitet për financimet e fushatave zgjedhore?

Kristaq Kume – Ky draft që na keni dhënë ka të bëjë vetëm me dy çështje, me çështjet e financës dhe të barazisë gjinore. Për këto i thashë dy fjalë këtu. Kam thënë shumë më tepër fjalë dhe mendime konkrete, që ju mund t'i konsideroni në materialin që kam sjellë në Kuvendin e Shqipërisë. Pastaj, për pikat e tjerat, kur të na thërrisni dhe kur të keni draftet gati, të japim edhe ne mendimet tona.

Thashë të mos bëni drafte vetë, por hajdeni t'i bëjmë bashkë dhe jo të na thërrisni dhe të na thoni: "Ne kemi shkruar këtë, si mendoni ju?" dhe pastaj vendosni ju. Të ndryshojmë qasjen. Hajdeni të bëhemi bashkë, që do të thotë të jemi të gjithë të barabartë kur t'i trajtojmë gjërat, si ju që jeni këtu në Kuvend, edhe ne që nuk jemi në Kuvend, parti politike dhe jo parti politike!

Rudina Hajdari – Zoti Kume, faleminderit për fjalën tuaj, për pjesëmarrjen dhe prezantimin e opinioneve që sapo dhatë!

Do të kalojmë te folësi i radhës.

A mund t'ia bëjmë pyetjen folësit të radhës?

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Është e padrejtë. Pse e bëni kështu? Unë do ta kisha mbaruar deri tani...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më pyetët mua.

Zoti Kume, ju lutem! Meqë thatë se i keni sjellë këtu mendimet tuaja dhe se në financimin e partive politike dhe në monitorimin e saj shoqëria shqiptare është shumë e prekur, a keni ju një mendim në lidhje me financimin, ku preket buxheti i shtetit ndaj subjekteve politike?

A do të ishte mirë që asnjë nga forcat politike të mos merrte financa për të kryer fushatën zgjedhore vendore dhe të përgjithshme? Pra, që të mos prekej buxheti i shtetit, si do të ishte...?

Kristaq Kume – Është në tagrin e Kuvendit. Ne jua kemi deleguar juve të drejtën që të merrni vendimin se si duhet të financohen partitë politike për fushatën e tyre zgjedhore. Një alternativë është kjo që kemi pasur deri sot, tjetra është kjo që thoni ju, që të mos marrin asnjë lek nga buxheti dhe tjetra është ajo që thotë opozita jashtë parlamentit, që të mos marrin asnjë lek nga të tjerët, por vetëm nga buxheti.

Hajdeni të bëhemi bashkë dhe të diskutojmë e të gjejmë se cila na përshtatet më mirë! Hajdeni të bëhemi bashkë dhe t'i diskutojmë!

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë!

Atëherë, kalojmë te folësi i radhës, zoti Merkoci, në emër të Lëvizjes Mjaft.

Aldo Merkoçi – Përshëndetje të gjithëve!

Së pari, dua t'ju falënderoj për ftesën!

Mendoj që është gjithmonë mirë që aktorët politikë të takohen edhe me shoqërinë civile.

Para se të filloj komentet e mia, dua të bashkohem me kritikata e dy kolegëve të mi parafolës, për sa i përket metodikës së konsultimit, e cila po ndodh për këtë reformë zgjedhore. Edhe nga mungesa e fokusit të anëtarëve të këtij komisioni, në këtë moment, vazhdon të mbetet një traditë e keqe se si ai bën konsultime publike. Bashkohem 100% me parafolësit dhe pa dashur t'i dublikoj në mendime, procesi i konsultimit, sidomos për sa i përket reformës zgjedhore, duhet të jetë shumë i rëndësishëm dhe unë nuk shoh as sot dhe s'kam parë as më parë, kur na erdhi drafti, ndonjë seriozitet nga ana juaj. Nëse themi se kemi një problem me reformën zgjedhore, do të thotë se problemi jeni ju, zotërinj dhe partitë politike, nuk janë njerëzit. Pra, nëse sot flasim që reforma jonë zgjedhore e ndryshuar, e cila deri sot ka ndryshuar 2-3 herë, akoma nuk po gjen një model të saktë, kjo nuk vjen se qytetarët shqiptarë nuk e kuptojnë reformën zgjedhore, por vjen se partitë politike dhe anëtarët e tyre shtrembërojnë cilindo prej modeleve që kemi pasur deri sot. Kur flasim për krizë parlamentare dhe se si do të arrijmë t'i monitorojmë partitë politike dhe kandidatët në financimin e partive politike (ndoshta është një nga çështjet më të rëndësishme që po diskutojmë sot, duke qenë se metodika e reformës zgjedhore nuk është pjesë e këtij debati, edhe pse duhet të jetë), duhet ta bëjmë të qartë si për publikun ashtu dhe për ju që ky nuk është një problem që na vjen nga alienët, por nga partitë politike dhe nga ju. Nëse sot ne kemi probleme me abuzime me fondet të cilat nuk i njohim se nga na vijnë gjatë fushatës zgjedhore, ky është problemi juaj.

Ne, si shoqëri civile, kemi për detyrë t'ju monitorojmë dhe të gjejmë disa skema alternative se si kjo gjë mund të korrigjohet. Në këtë kuadër, disa nga gjërat që kemi çuar, edhe me shkrim, nuk janë të mjaftueshme, sepse ato janë vetëm disa komente paraprake, pasi koha ishte e limituar, megjithatë dua të them disa gjëra shkurtimisht:

Nga një vrojtim që kemi bërë në vitin 2013 për shpenzimet e fushatës elektorale na rezultoi se raporti mes asaj çfarë partitë politike deklarorin si shpenzime në KQZ dhe asaj që ne monitoruam në mënyrë të tërthortë në rang kombëtar ka një diferencë nga 2 deri në 3 herë më të madhe. Ky është një sinjal i rrezikshëm jo vetëm se kemi në qarkullim para që nuk e dimë nga vijnë, por edhe sepse sot ne nuk e dimë dhe nuk jemi në gjendje të kuptojmë se kush i solli këto para të padeklaruara dhe me çfarë përfitimi pas mbarimit të zgjedhjeve.

Në këtë kontekst, një problematikë tjetër, që do të doja ta nënvijëzoja, se e ka në mangësi në frymë ligjit, është mosmonitorimi apo mosmarrja fare parasysh e medieve sociale. Duhet pasur parasysh se që nga zgjedhjet e vitit 2009, sidomos nga zgjedhjet e vitit 2013, e deri në zgjedhjet e fundit, një pjesë e mirë e buxhetit të partive politike shkojnë në mediet, sociale, *facebook*, *instagram*, *google* dhe të gjitha *outlet*-et e tjera.

Kjo është një problematikë shumë e madhe për dy arsye: e para, duke i qëndruar stigmës së mosdeklarimit të shpenzimeve të partive politike, është që, deri në zgjedhjet e fundit asnjë prej partive të regjistruara në zgjedhje nuk ka deklaruar qoftë dhe një qindarkë për shpenzime në mediet sociale dhe besoj se nuk ka nevojë t'jua themi ne, sepse keni qenë ju të parët që keni shpenzuar në mediet sociale për faqen tuaj të *facebook*-ut, për faqen e partisë, apo për reklama të ndryshme. Unë i kam monitoruar dhe e di këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk është nominale.

Kësisoj, një mangësi shumë e madhe që e ka ky draft është përjashtimi apo mospërlllogaritja në përgjithësi i këtij *outlet*-i mendiesh, pra rrjetet sociale. Një problematike tjetër që lidhet ndoshta në mënyrë të tërthortë, por që unë doja ta cekja këtu, meqenëse jemi për financimin dhe për paratë e padeklaruara (nuk ka lidhje me draftin, por me temën), është se ne jemi sot i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që nuk kemi një ligj lobimi dhe ndoshta kjo është arsyeja pse raste të ligjeve të përvitshëm dhe kontraktuale.

Ne e kuptojmë dhe nuk ka asnjë gjë të keqe që një biznesmen apo një grup investitorësh të kenë një interes të veçantë, por ama e gjithë bota e ka rregulluar këtë, sepse ka nevojë të rregullohet, me qëllim që të kuptohet se kush janë këta biznesmenë që investojnë në partitë politike, apo për nene të caktuar direkte, se nuk ka nevojë që të gjithë të investojnë në partitë politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të trajtosh një draft për 5 ditë dhe ta thuash për 5 minuta atë që ekspertët kanë bërë për një vit është pak e vështirë. Ne prandaj jemi këtu për t'i dhënë një kontekst ngjarjes, pra pse unë mendoj që kjo gjëja është problematike dhe nëse nuk e jap dot kontekstin, nuk e bëj dot.

Financimi dhe auditimi.

E kemi vënë në Kodin Elektorale, pra në kodin e ri, si draft, dhe kemi parashikuar që do të ketë auditues financiarë dhe monitorues financiar, të cilët veprojnë në terren, pra monitorimi në terren i aktiviteteve fizike të partive politike. Këtë e them për ata që nuk e dinë.

Tani kemi dy probleme: këta njerëz, siç është parashikuar nga ligji dhe Rregullorja e KQZ-së, janë i njëjti grup njerëzish, pra kur KQZ-ja auditon audituesit, janë po ata që bëjnë dhe monitorimin financiar. Ky është një problem parimor dhe askush tjetër nuk e ndjek këtë lloj metodologjie, sepse ai që monitoron në terren dhe ai që bën audituesin duhet të jenë dy identitete të ndryshme.

Rudina Hajdari – Zoti Mërkoçi keni një pyetje nga një prej anëtarëve, kështu që mund t’i përgjigjeni.

Aldo Mërkoçi – Kam edhe një fjali dhe e mbarova. Edhe në rastet kur KQZ-ja administrative gjen shkelje gjatë zgjedhjeve, problemi që kemi sot është se KQZ-ja administrative duhet ta çojë atë te KQZ-ja politike dhe është kjo e fundit që merr vendime apriori përveç asaj që keni shkruar apo sugjeruar në kod.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Duke falënderuar secilin prej përfaqësuesve të shoqërisë civile për opinionet e tyre të vyera, por mbi të gjitha për opinionet me shkrim, do t’ju rikujtoj se çdo fjalë e thënë këtu duhet të bazohet në disa fakte. Sapo thatë disa të pavërteta për faktin se politikanët shpenzojnë për faqet e tyre të *facebook*-ut. Këtu jemi disa deputetë që mund t’ju thonë se kjo është tërësisht e pavërtetë, sepse sikundër dhe ju, llogaritë tona janë publike dhe mundësohen nga *facebook*-u pa pagesë.

Së dyti, do t’ju lutesha që, sa herë që vini këtu, të sillni propozime konkrete dhe vlerësime për problematika, se opinionet tuaja do të na shërbejnë shumë edhe të pjesa e përmirësimit të draftit. Ne jemi të gjithë dakord që reforma është e nevojshme, duhen bërë përmirësime në menaxhimin dhe mirëmenaxhimin e financave të partive politike në pjesën e auditimit dhe të barazisë gjinore. Po të vazhdojmë kështu ka shumë çështje për të cilat biem dakord se duhen ndryshuar, prandaj në kohën që keni në dispozicion më mirë na jepni propozime konkrete dhe jo vetëm vlerësim të situatës, se të gjithë jemi dakord që ka nevojë për përmirësim. Nga ana tjetër do t’ju lutesha përsëri që të merrni informacion para se të jepni disa konstatime! Audituesit dhe monitoruesit nga KQZ-ja ekzistojnë sot. A ka nevojë për përmirësim në nene të caktuara? Patjetër që ka. Ju lutem, ndonjë propozim konkret!

Faleminderit!

Aldo Mërkoçi – Me të gjithë respektin që kam për të gjithë anëtarët e këtij komisioni, unë, edhe të mos isha këtu, nuk besoj se do t’i lejoja vetes të thosha një gënjeshtër. Nuk thashë që të gjithë deputetët bëjnë shpenzime në faqet e tyre të *facebook*-ut, por ama nëse ju më thoni që në të gjitha zgjedhjet që nga viti 2009, PS-ja, nuk ka bërë asnjë shpenzim *online* në fushatë elektorale, po ju them se kjo është një e pavërtetë shumë e madhe dhe shumë e rrezikshme se sa ajo potenciale. Ajo që po thosha, mbase nuk e formulova mirë dhe më vjen keq që nuk më kuptove, është se unë po adresoj faktin se fushatat elektorale në Shqipëri nga 2009-ta e deri sot po bazohen gjithmonë e më shumë, dhe kur them “bazohen” e kam fjalën jo vetëm në përmbajtje, por edhe në shpenzime, pra në buxhet, në mediet *online*, të cila i njohim të gjithë. Medie *online* është edhe kur dikush hyn në një faqe *website*-i të futbollit në Angli

dhe aty të del një nga kandidatët për parlament. Pra është *google*-i që na lejon nëpërmjet IP-ve të kapë masën e gjerë të njerëzve. Ajo që më shqetëson, dhe ky është fakt të cilit unë i qëndroj ditë e natë, është se në 3-4 zgjedhjet e fundit ka pasur shpenzime në mediet *online* dhe asnjë nga partitë deri sot nuk ka deklaruar asnjë lek të shpenzuar. Se sa e madhe është kjo peshë dhe se si do të rregullohet është një çështje që patjetër ka nevojë për debat, por kur unë marr në dorë një draft-propozim duhet të marr edhe një relacion se cilat janë problematikat që ka gjetur ky Kuvend. Në këtë draft mungon pikëpamja juaj, pra çfarë mendoni ju. Cilat janë këto problematika që na bën ta ndryshojmë draftin, se as ky nuk ishte në relacion? ODIHR-i është një organizatë e cila e bën vet dhe patjetër që ne do ta marrim parasys.

Rudina Hajdari – Zoti Mërkoçi shumë faleminderit!

Në respekt të nënkryetare së Kuvendit të bëni pyetje dhe jo komente!

Vasilika Hysi – Unë dëgjova me vëmendje, se nuk kam lexuar se çfarë kanë depozituar me shkrim, por për çështje për të cilat flitet në përgjithësi dhe nuk ka përgjigje në dokumentet që kemi administruar, unë ju falënderoj që na i vënë në dispozicion në formatin *online* dhe të printuar, ne kemi të drejtë të pyesim, aq më tepër që sot po diskutojmë çështje që lidhen me grupin e punës ku unë dhe zoti Nimet jemi të ngarkuar të mbajmë shënime dhe t'i reflektojmë. Unë do t'ju falënderoja të gjithë për komentet dhe sugjerimet dhe për materialet që keni sjellë! Në fjalën tuaj ju përmendët që mediet sociale nuk mund të monitorohen, për rrjedhojë nuk mund të monitorohen as shpenzimet. Jam dakord me ju. Janë 800 medie sociale të paregjistruara, gati 760, të AKEP-i janë të regjistruara, dhe sipas informacionit të që na kanë dhënë, vetëm 37, nuk monitorohen. A keni ndonjë sugjerim konkret, ndonjë model se si mund të monitorohen 800 faqe medie, adresa të regjistruara jashtë Shqipërisë dhe si mund të monitorohen kostot financiare të mbajtjes së tyre, të njerëzve që punojnë dhe të parave që partitë politike paguajnë për të bërë fushatat në medie, keqinformimet, por dhe ndikimet e tjera.

Faleminderit!

Aldo Mërkoçi – Shumë faleminderit!

Mendoj që kjo është relativisht një pyetje teknike, megjithatë zgjidhja është teknike, se duhet të ketë ekspertë që merren me këtë gjë, por mendoj që nuk është gjë e pamundur. Se sa vetë punojnë në për ato faqe sociale nuk është pjesë e diskutimit, prandaj të fillojmë me atë që mund të matim. Kërkesa ndaj *google*-it apo *facebook*-ut apo *instagram*-it, janë procedura të ndjekura edhe nga shtete të tjera nuk është se duhet ta shpikim ne. Të gjitha këto medie sociale kanë një sistem algoritmi dhe ka disa kompani të profesionalizuara, të cilat mund të

ndërhyjnë për të kuptuar se cilat janë, në bazë të IT-ve në Shqipëri, shpenzimet e faqeve që etiketohen nga KQZ-ja.

Unë e kuptoj që është e vështirë dhe më vjen shumë mirë që edhe ju e keni marrë përsipër ta bëni këtë diskutim dhe mendoj se zgjidhja relativisht teknike është e bëshme, pra nuk është se duhet ta shpikim ne. Nuk do të doja që të kishim përshtypjen, se dua ta nënvijëzoj, se financimi i partive politike çalon vetëm te mediet *online*, pasi mendoj se ka shumë problematika të tjera. Nga monitorimi që kemi bërë pjesa më e madhe e shpenzimeve, që bëjnë partitë politike i bëjnë në terren. Ne kemi akoma problematikën e çfarë parash shpenzojnë ne terren dhe sa prej tyre deklarohen, pra po flasim si në rangun e mitingjeve të mëdha në qendër-qarqe apo në qytete, si për të gjitha takimet që deputetët bëjnë në zonat elektorale, ashtu dhe për takimet nëpër fshatra. Këto janë një numër i pafund takimesh, të cilat ende, në një pjesë të madhe të tyre, nuk raportohen nga partitë politike. Nëse këto aktivitete bëhen, me çfarë parash bëhen? Unë mendoj që duhet një kryqëzim edhe me ligjin e lobimit. Më falni, zonja Gjylameti, nuk thashë që KQZ-ja nuk ka auditues, por KQZ-ja i kontraktton audituesit për hir të së vërtetës, nuk i ka të vetët, ashtu sikurse edhe monitoruesit financiarë.

Jam shumë i qartë për ato që komentoj dhe nuk tentoj të bëj...

Rudina Hajdari – Faleminderit!

Myslim Murri – Pyetjen ta bëri edhe kolegja Hysi.

E para, jam dakord me ty, që pas çdo portali prapa ka një grup hajdutësh, që nuk i deklarojnë paratë, që i kanë kthyer mediet në biznes dhe gjuajnë me 12,7 njëlloj si bandat në '97-ën atë që nuk është në linjën e tyre. Ashtu siç më kanë thënë, një portal minimalisht kërkon 3 apo 4 mijë euro në muaj nëse është i vogël, nëse është i madh nga portal të dalë televizion duhen 20 mijë euro në muaj. Nga vijnë këto para? Zero të deklaruar!

Më bëri shumë përshtypje dhe prandaj e kapa telefonin menjëherë, sepse e di që ma bën si nder Zykja i *Facebook*-ut çfarë postoj, sepse po të më vjedhin lekët i lashë kalamajtë pa bukë. Ti the që të gjithë që postojnë në *Facebook* paguajnë lekë, por unë kokërr leku nuk paguaj, ndërsa hajdutët që kanë hapur portalet po.

Zotërinj, unë postoj në *Facebook*, kam 4-5 mijë veta që i mërzis me postimet e mia, nuk paguaj asnjë lek, pasi rogën siç e marr e dërgoj direkt në shtëpi. Po të më vjedhë Zykja lekët, i lashë kalamajtë në rrugë. Kështu që duhet të jesh i qartë, nëse ke këllqe, fol për hajdutët që kanë nga një portal dhe që shtohen çdo ditë si kërpudhat dhe i përdorin për qëllime të pista, duke luftuar ata që nuk i kanë fijet vetë.

Kisha një pyetje për ju konkretisht. Jam shumë dakord që do të monitoroni fushatat, edhe partitë gjatë viteve, edhe takimet e deputetëve e të tjera. Ju vetë jeni vullnetar apo ju paguajnë?

(Diskutime pa mikrofon)

Konkretisht e kam me ty. Do të merrni fonde nga KQZ-ja, nga buxheti i shtetit, pasi thatë që duhet të keni edhe monitorues vullnetarë, edhe ekspertë financiarë për të bërë llogaritë e fushatave. Ju vetë nëse jeni grup vullnetarësh, lum si ne se do të na e zgjidhni këtë punë. Po juve kush ju paguan?

Aldo Merkoci – Faleminderit për pyetjen dhe shqetësimin që ngritët!

Nëse e dëgjuat, ju referova një monitorimi, të cilin e kemi bërë në vitin 2013...

(Diskutime pa mikrofon)

A mund ta mbaroj fjalinë?

...Organizata që unë përfaqësoj është lëvizja “Mjaft”. Donatorë në vitin 2013 kanë qenë dy ambasada të huaja, të cilat për momentin nuk besoj se është e nevojshme t’i bëj publike...

(Diskutime pa mikrofon)

Për çfarë e doni transparencën?

(Diskutime pa mikrofon)

Për emrin e dy ambasadave?

Klotilda Bushka – Faleminderit, kolegë deputetë!

Damian Gjikhuri – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Kemi gjithë kohën për të diskutuar së bashku.

Ju falënderoj që më dhatë fjalën.

Në radhë të parë dua të sqarojmë një gjë, shoqëria civile ka rolin e saj për të na monitoruar dhe të jetë syri dhe të bëjë *watch dog*-un për veprimtarinë e politikës, të qeverisjes, të parlamentit e me radhë.

Ashtu siç ka transparencë aktiviteti i parlamentit apo i qeverisë, edhe shoqëria civile ka transparencën e saj për të kontrolluar donatorin që bën financimin për një projekt, duke ia kontrolluar me transparencë. Nuk do të doja të ngelemi te kjo pikë, sepse qoftë puna vullnetare apo puna e bërë nëpërmjet projekteve të dhëna nga donatorë apo nga partnerë është një punë e vlefshme e shoqërisë civile, të cilën duhet ta nxisim, por edhe shoqëria civile duhet të jetë e përgjegjshme, që në deklaratimet që ajo bën të jetë e bazuar në të vërteta, sepse tek e fundit interesi i shoqërisë civile është që transparenca të jetë në maksimum e bazuar në fakte dhe prova.

Pikërisht te kjo e fundit do të ndalem pak dhe kam dy pyetje. Ju thatë, jam dakord edhe me kolegët deputetë, që për rrjetet sociale nuk paguajnë deputetët, si *Facebook*-u e të tjera. Nëse ju flisni, besoj se këtu është keqkuptuar çështja e portaleve *online*, ku ashtu siç nxirren lajme për të favorizuar apo për të hedhur baltë për një subjekt të caktuar, ka edhe sponsorizime për lajme të caktuara dhe kjo ka bërë që i gjithë ky sektor, këtu jam shumë dakord me ju, të mos jetë i futur në shina ligjore transparente dhe kontrolli.

Pyetja që unë kam është: ju gjykoni që të jetë pjesë e reformës zgjedhore, të adresohet në këtë kuadër, duke pasur parasysh financimet që kanë subjektet gjatë zgjedhjeve dhe gjatë kohës që veprojnë, nëpërmjet aktiviteteve të medieve sociale, ku përfshihen portalet *online*? Nuk jam duke folur për *Facebook*-un dhe *Twitter*, të mos ngatërrohemi, sepse janë dy gjëra të tjera.

Pyetja e dytë. Ju thatë që KQZ-ja duke qenë se ka konstatuar fakte gjatë aktivitetit të tij që kanë përbërë shkelje të veprimtarive zgjedhore nuk ka marrë vendime, se është i politizuar, thatë ju. Ju gjykoni që depolitizimi i Komisionit të Zgjedhjeve dhe gjetja e formulave, ku Komisioni i Zgjedhjeve të mos jetë një produkt i votës së partive politike, i subjekteve të përfaqësuara apo jo në Kuvend, pra të mos jetë produkt i vendimmarrjes politike, do t'ia rrisë pa diskutim këtë lloj veprimtarie? Ne e dimë që depolitizimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo i institucionit që do të merret me zgjedhjet do të rrisë besueshmërinë te publiku sa i takon vendimmarrjes dhe pa diskutim do të krijojë edhe një lloj transparence më të plotë dhe do të ketë një distancë nga politika. Sa u takon çështjeve që ju shtroni, si shkeljet e procesit zgjedhor apo shkeljet administrative, a do të ndikojë kjo gjë? Pra, vetëm kjo është arsyeja se si mund të bëhet puna më efiçente apo ju keni gjetje të tjera për atë që paraqitet?

Faleminderit!

Aldo Merkoçi – Sa i takon pyetjes së parë fokusi më i madh, gjatë vitit elektoral, duhet të jetë për matjet e shpenzimeve *online* dhe kjo për dy arsye. Duhet të kuptojmë që dinamika e lajmeve *online* është një çështje shqetësuese jo vetëm për çështje parash, por edhe për çështje influence. Ky është një debat që po bëhet edhe në vende të tjera europiane, për faktin se kush i sponsorizon, sepse nuk është vetëm çështja e partive politike kur hedhin baltë mbi njëra-tjetrën, por është edhe çështja e një entiteti të tretë, i cili mund të ketë influenca apo dëshirë për të influencuar zgjedhjet në Shqipëri. Ky është një test me të cilin po merret edhe Perëndimi dhe besoj se duhet të merremi edhe ne. Kush janë këta njerëz, të cilët influencojnë gjatë vitit elektoral në Shqipëri dhe gjatë periudhës së zgjedhjeve? Unë mendoj që kjo gjë duhet të futet sa më parë, që me këto zgjedhje, se si do të përshkallëzohet skema për të

kërkuar nga *Google* apo qoftë edhe nga *Facebook*-u, sepse është e njëjta skemë, se si duhet të ndërtohet nga KQZ-ja që të marrë deri diku autorizimin për t'u kërkuar informacione *outle*ve medietike apo *online* siç janë *Google* apo edhe *Facebook*-u. Kjo gjë duhet bërë që këtë vit, siç jua thashë, jo vetëm për çështjen e monitorimit të financimit, por edhe për faktin që të dihet se kush janë këta aktorë, të cilët duan të influencojnë zgjedhjet.

Sa i takon pyetjes së dytë për KQZ-në, është një pyetje e drejtë dhe shumë interesante. Mendoj që ka dy gjëra, të cilat mund të bëhen. Patjetër që depolitizimi i KQZ-së do të sillte një imazh më të mirë, një besim më të madh dhe ndoshta edhe një punë më të mirë, por edhe më herët se kaq disa shkelje, të cilat janë administrative dhe janë raportuar në ndryshimet që i janë bërë Kodit bashkëngjitur Rregullores së KQZ-së nuk kanë pse të jenë më vendime të KQZ-së politike, por të jenë thjesht mendime të KQZ-së administrative.

Pra, nëse administrata gjen një shkelje, ajo duhet të raportojë direkt dhe nuk ka pse të shkojë më për debat politik, pasi jemi duke folur për problematika, të cilat ende ekzistojnë dhe për këtë arsye po bëhet edhe Kodi Elektoral, prandaj kemi edhe një Rregullore të KQZ-së, e cila e përcakton shumë qartë se ku është shkelja dhe nuk ka pse të bëhet më debat politik për këtë çështje.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Merkoçi!

Aldo Merkoçi – Faleminderit juve!

Rudina Hajdari – Do t'ju lutesha të mos dalim jashtë temës, pasi po shpërqendrohemi dhe po kapemi me tema të tilla siç është ajo për mediet sociale, ndërkohë që kemi probleme shumë më të rëndësishme sa i takon Kodit Elektoral.

Zoti Gogo, në mos gaboj, në fillim të fjalës së tij foli për një korrupsion galopant, një krizë politike të jashtëzakonshme, për përfaqësuesit jashtë parlamentit dhe për situatën e jashtëzakonshme ku ndodhemi sot. Përtej kësaj të gjithë jemi të ulur këtu dhe kemi vullnetin për të bërë diçka, prandaj t'i ngelemi kësaj teme dhe të flasim konkretisht lidhur me të gjitha gjërat që kanë shkruar ekspertët.

Ju kujtoj edhe një herë, pasi ju mund të kërkoni se çfarë kanë shkruar ekspertët lidhur me regjistrimin e kandidatëve, barazinë gjinore, e cila u prek ndonëse pak, lidhur me votimin familjar dhe votimin e tretë, financimin elektoral, me problemet e blerjes votës, të cilën nuk e preku askush dhe askush nuk na tha asnjë propozim konkret, përdorimin e burimeve të administratës, monitorimin e fushatës zgjedhore dhe problematika të tjera. Unë besoj se duhet të ngelemi këtu, sepse vërtet këto janë gjëra që duhet t'i shohim seriozisht dhe të mos merremi me mediet sociale.

Faleminderit!

Përfaqësuesi i radhës vjen nga nisma “Thurje”. Këtu janë tre emra dhe nuk e di se cili do ta marrë fjalën. Keni 5 minuta në dispozicion.

Zoti Shabani, fjala është për ju.

Më pas fjalën do ta marrin anëtarët e komisionit nëse kanë pyetje.

Endri Shabani – Përshëndetje!

Unë vij nga nisma “Thurje” dhe ashtu sikundër ju mund të jeni në dijeni, ne kemi ndërmarrë një iniciativë tashmë prej gati 7 muajsh, për mbledhjen e firmave për ndryshimin e sistemit zgjedhor. Ne gjykojmë që sistemi zgjedhor është në thelb problemi që ka sot shoqëria shqiptare. E gjithë problematika që krijohet dhe të gjitha krizat që përsëriten çdo 2 vjet dhe natyrisht probleme të tjera që lindin sa i përket pjesës së përfaqësimit politik lidhen me sistemin zgjedhor.

Deri më sot janë mbledhur rreth 50 mijë firma, të cilat janë mbështetëse për ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe njëkohësisht kemi organizuar në 8 qytetet kryesore të vendit takime për t’u shpjeguar dhe për të marrë opinionin e njerëzve sa i përket pjesës së përfaqësimit politik, duke pasur edhe gjithë mirëkuptimin e këtyre njerëzve.

Për të adresuar problematikën që i përket pjesës së sistemit zgjedhor parimi kryesor është parimi sovran i votës së lirë dhe të ndershme. Ne gjithmonë jemi kujdesur për një votë të lirë, por asnjëherë nuk jemi kujdesur për një votë të ndershme. Pra, mënyra se si është ndërtuar ky sistem elektoral është që votën mund ta bëjmë shumë të lirë dhe të marrim të gjitha masat që vota të mos vidhet, të mos blihet apo të mos shitet...

Rudina Hajdari – Si mund ta bëjmë këtë? Ju lutem, na thoni fjalë konkrete, sepse problemet i dimë dhe për këto arsye duam propozime konkrete se si mund të arrijmë te vota e ndershme.

Endri Shabani - Çfarë do të thotë votë e ndershme? Votë e ndershme do të thotë që populli ta zgjedhë vetë deputetin, t’i vërë kryqin emrit, jo partisë politike dhe pastaj kryetari i partisë të bëjë listën e deputetëve. Votë e ndershme do të thotë që...

(Diskutime pa mikrofon)

Votë e ndershme në parimin, votë e lirë dhe e ndershme. Pra, është një parim sovran vota e lirë dhe e ndershme, nuk ka kushtues. Vota e lirë dhe e ndershme është rendi politik që ne kemi zgjedhur. Për ta kuptuar. Sistemi proporcional kombëtar, që është një sistem proporcional me lista të hapura, është sistemi që adreson gjithë problematikën që ka sot pjesa e përfaqësimit politik në Shqipëri.

E para, adreson zgjedhjen e deputetit drejtpërdrejtë nga populli. Pra, deputeti merr përfaqësimin sovran nga populli.

(Diskutime pa mikrofon)

Nga qytetari nuk ka rëndësi, si të doni ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne nuk flasim në emër të popullit. Unë vetë popull jam, qytetarë janë ata të tjerët.

Atëherë, merr sovranitetin nga qytetari në mënyrë të drejtpërdrejtë.

E dyta, pasja e një sistemi të copëzuar, siç është ai rajonal aktualisht, ka sjellë të gjitha këto deformime që vijnë për shkak të influencave lokale që krijohen. Çdo lokalitet ka ata të fortët e vet, pra janë krijuar padronët e lokaleve, të çdo ndarjeje lokale që ka sot Shqipëria.

Çfarë sjell bërja kombëtar? Të kthehem pak edhe te pikat kryesore të OSBE-ODIHR-it, që është pika e dytë dhe në të thuhet: “Si mund ta shmangim blerjen e votës? Ta bëjmë kombëtar.” Duke e bërë kombëtar, ne do të dimë si të incentivojmë të gjithë ata individë, të gjitha ato struktura, të cilat në proporcional rajonal janë të incentivuara për t’u futur në politikë. Në momentin kur e hapim sistemin dhe e bëjmë kombëtar, atëherë të gjithë dezincivohen, sepse tashmë është e vështirë ta blesh votën nga Konispoli në Vermosh, por është më e lehtë ta blesh në Fier, në Shkodër, në Krujë, në Durrës e në Gjirokastrë. Pra, proporcionali kombëtar me lista të hapura na sjell dy të mira:

Së pari, ngre peshën e sovranit në zgjedhjen e deputetëve, pra përfaqësimin e drejtë politik të tyre.

Së dyti, na shpëton nga të gjitha deformimet që janë bërë për shkak të rajonalizimit. Këtu adresohet pika 2, që është pika kryesore e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, për të shmangur blerjen e votës, sepse ai nuk mund të blejë votë nga Konispoli në Vermosh. Në qytetin e vet, ai e blen votën, në rajonin e vet po ashtu, por nga Konispoli në Vermosh nuk e ble dot. Duke humbur peshën, ata dezincivohen dhe duke u dezincivuar ata humbasin interesin, dhe kështu i shmangen politikës. Në momentin kur ne nuk u krijojmë kushtet, u heqim mundësinë për të përfituar nga politika, atëherë do të shikojmë që aty do të fillojë të realizohet edhe një herë ajo që ne kemi dashur deri sot, për të pasur një parlament sa më përfaqësues dhe cilësor.

Kemi edhe dy-tri rekomandime të tjera.

Rudina Hajdari – Zoti Stoku, ju thatë që propozimet tuaja në lidhje me ndryshimin e sistemit adresojnë pikat 2 dhe 3 të rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, atëherë, ju lutem, herës tjetër dua një propozim konkret. Ne kemi një grup pune që merret me këtë çështje, kështu që paraprakisht ju duhet ta depozitoni në mënyrë elektronike. Sot ju nuk keni depozituar gjë, kështu që kolegët nuk e kanë këtë që ju sapo propozuat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Panajot Soko – Ne do të depozitojmë një nismë ligjore, e cila aktualisht ka 50 mijë firma.

Damian Gjijnuri - Meqenëse e dëgjoj shpesh që vetëm sistemi e zgjidh çështjen e shitblerjes së votës dhe jo procedura penale apo Kodi Penal, kam një pyetje: supozojmë se kemi një subjekt politik, që zgjedh 12 kandidatë, blerës votash, në 12 qarqe me një sistem proporcional kombëtar, si e pengon sistemi proporcional kombëtar një parti të vogël, e cila hyn me qëllim për të blerë vota dhe për të nxjerrë disa deputetë?

Panajot Soko – Do të bëje dhe unë një pyetje: si është më e lehtë, të blesh një kryetar partie apo të blesh një popull prej 3 milionë banorësh? Unë mendoj se, nëse ne kemi një proporcional kombëtar me lista të hapura, partia duhet të blejë një popull dhe, nëse ju mendoni se një popull i tërë mund të blihet, atëherë ta lëmë demokracinë dhe të kalojmë tek autokracia dhe nuk ndodh asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjijnuri - Pra, votat do të merren në të njëjtën zonë, në të njëjtin qytet, me qëllim të qartë për të blerë vota në 12 qarqe, që përfaqësojnë një parti të vogël, e cila do të krijohet me qëllime të caktuara. Si e pengon ti konspiracionin e njerëzve në çdo qark për të prodhuar disa mandate?

Panajot Soko – Për pjesën e blerjes së votave, duhet simuluar një situatë, nga e cila, po themi, që ta kuptojmë qartë: 12 veta në 12 qarqe blejnë vota për një person. Atëherë, ky do të ishte rasti ideal kur ne do të kishim një investim kaq të madh të një force politike për të futur një person të blejë 12 vota për 12 njerëz. Pra, me këtë sistem që kemi, të 12 këta do të guxonit të ishin brenda në parlament, por, nëse këta të 12 luftojnë për të nxjerrë vetëm një nga këta, atëherë sapo kemi arritur një rezultat. Pra, e kemi minimizuar.

Damian Gjijnuri - Mund të duket çudi, por këtu parti me 4 mandate kanë marrë 30% të qeverisjes së vendit. Kështu që ajo vjedhja e votës si 1 mandat, si 5 mandate është vjedhje vote. Këtë e them që të mos jepni hipoteza të tilla: nëse bëhet kjo gjë, nuk ka vjedhje. Mos lidhni fenomenin kriminal me sistemin!

Së dyti, ju nuk iu përgjigjët asaj që unë pyeta, se po të kisha qëllime kriminale mund të krijoja një parti për të marrë 4-5 mandate, që në një sistem proporcional janë magjike për të bërë 71-shin dhe të shantazhoja shtetin me 20-30% të pushtetit.

Panajot Soko – Ju jeni përfaqësues të popullit, dhe meqë na thirrët në komision, na dëgjoni, të paktën, meqë bëtë edhe pyetje.

Atëherë, proporcional kombëtar me lista të hapura do të thotë që secili nga ata kriminelët, për të cilët ju flisni, duhet të marrë vota në të gjithë Shqipërinë.

Ky është një sistem, i cili në Kosovë ka prodhuar një rezultat, të cilin nuk ka asnjë shans, që sistemi që ju keni sot, ta prodhojë në Shqipëri, pra ka prodhuar një parti *anti-establishment*, ka prodhuar brenda një partie të vjetër një kandidate si Vjosa Osmani, e cila doli në krye. Cili është qëllimi i këtij sistemi? Qëllimi i këtij sistemi është t'iu çliruar ju, zoti Gjoknuri, dhe të gjithë ju, që jeni sot këtu nga kryetari i Partisë. Unë jam i sigurt që ju vetë dëshironi ta ndryshoni këtë sistem, por nuk jeni të lirë të votoni, për t'iu çliruar ju nga grupet kriminale, të cilat nga kjo ndarje territoriale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kam për ju, e kam për këta që duan të fitojnë lirinë.

Rudina Hajdari - Zoti Alimadhi.

Adriati Alimadhi – Ju falënderoj dhe i çmoj si shumë të vlefshme të gjitha organizatat që ekzistojnë në Shqipëri. Të gjitha kështu flasin, në fakt, por na dalin edhe disa probleme gjatë rrugëtimit. Rekomandimi i OSBE-ODIHR-it është një mundësi. Në fakt, ju jeni për një sistem proporcional të pastër kombëtar. Për këtë jemi edhe ne, dhe kemi vite që e kërkojmë. A mund të keni një mendim tuajin se si mund të zgjidhet problemi i barazisë gjinore, me një sistem të pastër kombëtar dhe me lista të hapura?

Panajot Soko – Zgjidhet përmes kuotave. Normalisht partitë kandidojnë me lista, pra ne jemi për proporcional kombëtar, jo për maxhoritar. Duke qenë proporcional është absolutisht e lehtë, siç e kanë zgjidhur 22 nga 27 vendet e BE-së, të cilat kanë proporcionalin kombëtar me lista të hapura. Këtë sistem e gjeni vetëm në vende autokratike. Pra, edhe problemi i barazisë gjinore zgjidhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithë Europa Perëndimore ka sistem të tillë. Ata thonë se është i mirë proporcionali krahasuar me maxhoritarin. Nuk jemi pro maxhoritarit, por ata kanë bërë një diferencë: nga proporcionali, kanë mbyllur listat. Mbyllja e listave ka krijuar autokratë brenda partive dhe ka sjellë të gjitha këto probleme, sepse shpesh aludohet që vendi në listë bëhet tender. Rekomandimet i OSBE-ODIHR-it, nuk mund të zgjidhen pa ndryshuar sistemin zgjedhor.

Unë mendoj se e keni bërë mbrapsht këtë punë, sepse pacienti ka nevojë për transplant, kurse ju i vini kompresa për të ulur temperaturën. Pra, këtu pa ndryshuar sistemin zgjedhor, të gjitha debatet teknike janë të panevojshme.

Duhet ndryshuar sistemi zgjedhor, pastaj flasim për elementet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Ju lutem, vetëm njëri prej jush mund të kthejë!

Zoti Gjoni.

Adriatik Alimadhi – Po pse na persekutoni kështu? Kisha edhe një pyetje tjetër shumë të dobishme. Në fakt, ju keni marrë një nismë, sepse ju shohim në rrjetet sociale, i keni bërë 50 mijë firma. Si mendoni se do ta zgjidhni? Ky sistem është i kapur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Unë dua të pyes për efektet që do të kishte një ndryshim eventual sistemi në transparencën e financimit të partive. Pra, që të thellohemi në atë që ngriti zoti Gjijknuri: nëse do të kishim një sistem proporcional kombëtar me lista të hapura, çfarë e pengon një të fortë në zonë, me shumë lekë, që të blejë kandidatë në mënyrë rajonale? Pra, një i fortë që ka lidhje në Delvinë, në Elbasan, në Shkodër, në Sarandë, në Vlorë, pra janë një grup të fortësh, që janë në aleancë me njëri-tjetrin, çfarë i pengon këta të fortë që të blejnë vota në mënyrë rajonale dhe matematikisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Stoku, ju kam dëgjuar, ju jeni shumë elokuent nga pikëpamja matematikore, sidomos kur vjen puna për ta thjeshtuar debatin matematikor. Në sistemin aktual që ne kemi, duhen mesatarisht diku te 10 mijë, po në një sistem proporcional me lista të hapura, a bie argumenti sa vota duhen për një kandidat që të dalë deputet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Panajot Soko – Sot, aktualisht vetëm 46% e njerëzve marrin pjesë në votime, sepse ky sistem zgjedhor i dekurajon njerëzit që të votojnë. Në një sistem zgjedhor ku 140 njerëz të çdo partie, do të bëjnë fushatë dhe do të kërkojnë sa më shumë vota, do të rritet edhe numrin e votave që duhen për t'u futur deputet.

Së dyti, një propozim tjetër teknik që ne kemi është votimi i emigrantëve. Duke rritur numrin e atyre që votojnë, që janë shqiptarë, që jetojnë në diasporë, prapë do të rritet numri i votave që duhen për t'u futur deputet. Për pasojë këta kriminelë, të cilët ju mendoni se mund të blejnë vota, vota që duhet të blejnë ata, duhet të jetë 10 herë më e lartë se ajo që blejnë sot, e para, sepse proporcionali do të jetë kombëtar, jo rajonal, dhe ata do të jenë irelevant, pra do të duhet të dalin jashtë zonave të tyre të influencës dhe, së dyti, numri i votuesve do të jetë shumë më i madh dhe votat që ata mund të blejnë do të jenë të pandikueshme krahasuar me atë që ndodh realisht sot.

Rudina Hajdari - Faleminderit shumë zoti Shabani dhe zoti Soku. Besoj se këtu mbaruam me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Damian Gjijknuri - Tani do të vazhdojmë me përfaqësuesit e partive politike.

Fjalën e ka zoti Kokëdhima, 5 minuta në lidhje me propozimet që keni mbi tavolinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Koço Kokëdhima - Faleminderit!

Shumë prej jush që jeni në këtë komision, ju njoh dhe kam shumë respekt për ju.

Diskutimi i sotëm më duket i kapur për bishti dhe jo për koke. Ne jemi duke i diskutuar këto probleme të mëdha për vendin në një mënyrë të gabuar. Nga një nivel bachelor do të kuptonin se gjëja e parë që duhet bërë është renditja, hierarkia e objektivave strategjike që dëshirojmë të arrijmë.

Pyetja e parë është: cilat janë objektivat që kemi përmes reformës zgjedhore ose reformës së sistemit politik, ose të ndonjë reforme tjetër që shihet e lidhur me këto, apo shihen të gjitha të lidhura me njëra-tjetrën? Çfarë duam të zgjidhim ne? Nëse ne kemi hallin të jemi në mirëkuptim me OSBE-ODIHR-in, pra nëse do të më thoni se merakun ynë i vetëm është që ata të kujtojnë se ne i bëmë disa gjëra nga ato që kërkojnë ata, unë them: kjo është diçka që nuk ia vlen mundimi, sepse mund t'i bëni vetë qokat që ju duhen dhe çdo gjë pastaj është në rregull.

Së pari, jo sipas rëndësisë, por siç më vijnë mua në mendje, mund të them: e para, unë dua që nga këto reforma që po diskutojmë, t'u hiqet pushteti abuziv dy-tri kryetarëve të partive, që po u marrin shpirtin dhe gjithçka popullit shqiptar dhe vendit tonë. Pra janë dy-tri kryetarë partish, që emërojnë të gjithë parlamentin dhe të gjitha pushtetet e tjera në Shqipëri. Ju mund të bëheni deputet, ndërsa ti zoti kryetar, nuk bëhesh dot deputet, po nuk desh kryetari yt, ti je një hiç, një nul, pra një asgjë. Kur them “ty”, nuk e kam për ty si person, por kam parasysh çdo deputet të Shqipërisë. Deputetët e Shqipërisë janë punëtorë të emëruar. Më vjen shumë keq që do ta konsideroni si mungesë respekti këtë që po ju them, por janë punëtorë të emëruar të dy-tri njerëzve. E gjithë Shqipëria është në funksion të këtyre dy-tri njerëzve, të pushtetit dhe të pasurisë së tyre, pra gjithçka në këtë vend është në funksion të tyre. Edhe sa do të vazhdojmë ne të gënjejmë njëri-tjetrin? Edhe sa? Ç'nevojë kemi të manipulojmë dhe të gënjejmë njëri-tjetrin?

Zotërinj, unë gjithmonë kur nisem për të ardhur këtu, vij me respekt në çdo debat dhe jam i interesuar të mësoj nga të gjithë njerëzit që flasin, por kam një paragjykim të madh sa herë që vij këtu, dhe mendoj: unë po shkoj, por nuk po flas me njerëzit e duhur, sepse ju këtu nuk keni gjë në dorë.

Shumica e miqve të mi, që janë në këtë krah, nuk do të donin fare t'i kishin përballë këta të tjerët. Ju nuk i llogarisni fare këta si faktorë për bërjen e kësaj reforme. Ju thjesht po konsumoni *show-in*, që duhet të bëni për funksionet që keni, ose sepse kështu është zakoni dhe kaq.

Ju i keni lënë një veto PD-së. Ju e bëni këtë punë vetëm me PD-në, vetëm me Lulzim Bashën. Ju nuk jeni aspak të hapur për të dëgjuar shoqërinë civile, faktorët e tjerë dhe popullin shqiptar, nuk keni asnjë interes, sepse as ju nuk keni gjë në dorë.

Lideri juaj e ka ndarë që këtë reformë e ka me Lulzimin (jo sot). Pse? Sepse Shqipëria nuk sundohet nga ligjet, nuk sundohet nga Kushtetuta. Shqipëria sundohet nga PS-ja dhe PD-ja. Domethënë, marrëveshja e tyre. Kjo marrëveshje vazhdon të jetë në fuqi e plotë. Diskutimi që ne bëjmë sot nuk është asgjë tjetër, veçse një farsë e radhës. Ju i keni dhënë të gjitha provat e mjaftueshme, që edhe kjo çështje është e zgjidhur me marrëveshjen midis këtyre dy kryetarëve.

Ti nuk ke vullnet, Damian. Unë të kam dëgjuar ty. Ti nuk ke vullnet të diskutosh sistemin. Nuk është vullneti yt, sepse nuk kanë vullnet ata të diskutojnë sistemin. Pa më thuaj ti, nëse je apo jo..., nuk diskutojmë moralisht asnjë. Nuk vëmë në diskutim njëri-tjetrin kurrë. Jemi të gjithë qytetarë, kemi respekt për njëri-tjetrin. Ma thuaj ti që ke një kulturë menaxheriale: si mund të diskutohet një çështje kaq e madhe pa pasur një projekt? Projekti politik shpjegohet me 10 fjali. I gjithë vizioni për çfarë ne diskutojmë janë 10 fjali, që duhet t'i deklarojë lideri i Partisë Demokratike. Cili është vizioni i tij për këtë krizë? Lideri i Partisë Socialiste. Para se ne të nisim të diskutojmë këto episode, këmba, këpuca, kjo, ajo, ne kemi në tavolinë vizionin, ku do të shkojmë dhe çfarë duhet të zgjidhim, zotërinj.

Ne duam të zgjidhim krizën, zotërinj të nderuar deputetë dhe anëtarë të këtij komisioni, krizën që e mban peng Shqipërinë për vite e vite me radhë. Ju doni ta zgjidhni? Ju nuk doni ta zgjidhni krizën, sepse nuk keni lirinë të mendoni për të zgjidhur krizën. Të zgjidhësh krizën do të thotë pikërisht t'i rrëzosh amendimet kushtetuese të 21 prillit të vitit 2008. Të zgjidhësh krizën, zotërinj, do të thotë t'i çlirosh zgjedhjet. Ju i vidhni zgjedhjet. I vidhni sistematikisht. Partia Demokratike është kusari i parë i zgjedhjeve shqiptare në gjithë historinë dhe ju ndoqët modelin e saj. Zgjedhjet shqiptare nuk kanë integritet, nuk i beson askush. Si mund të rivendoset integriteti i zgjedhjeve? Duke i numëruar, duke i transportuar ju ende kutitë e votimit shtigjeve, pyjeve, natën, andej-këtej, apo duke numëruar kutitë e votimit atje ku kutitë mbushen, atje ku votohet? Janë gjëra shumë të thjeshta, që i kupton kushdo. Nëse do të kishim vullnet, që t'i kthenim integritetin zgjedhjeve, kjo gjë do të ishte e mundur. Ja, pra, ne duam që me këtë reformë të vendosim sovranitetin e popullit. Deputetët të mos i emërojnë më kryetarët e partive dhe zgjedhjet të kenë integritet të plotë. Populli duhet t'i besojë plotësisht zgjedhjet. Kush do t'ia japë këto, marrëveshja juaj me PD-në? Ky diskutim është i nisur mbrapshtë.

Ky komision duhet të ishte i përbërë ndryshe. Ne kemi propozuar që duhet të kishte një konstitucionalist pa parti në krye dhe duhet të kishte gjithëpërfshirje. Duhet të kishte aktorë të rëndësishëm. Ajo që tha zoti Kume, i cili foli këtu më parë, nuk është se kërkoi diçka tuajën, sepse ju nuk keni diçka tuajën, në fakt. Ju këtu, zotërinj, duhet të ndiheni të barabartë me qytetarët e Shqipërisë dhe duhet të dëgjoni seriozisht e të zgjidhni të bëheni palë. Me kë do të bëheni palë? Do të vazhdoni të bëheni palë me kryetarët tuaj? Ata kanë arsye që e mbrojnë këtë sistem, kanë arsye që e mbrojnë këtë *status quo*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, po mbaroj fjalën.

Ata kanë arsye.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti ke nevojë të më dëgjosh mua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ke shumë nevojë të të ndihmoj të hapësh sytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ke shumë nevojë të dëgjosh, si unë dhe shumë të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjo, kryetar, sepse ke një shans të rregullosh diçka duke më dëgjuar mua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ky komision duhet t'i ketë aktorë të vërtetë këta. Unë i besoj këta, jo sepse janë burra ose gra më të mirë se ju, por sepse kanë një qasje të ndershme ndaj reformave që diskutojnë, janë të motivuar ndershmërisht. Karriera e tyre politike nuk është e lidhur as me PD-në, as me PS-në. Karriera e tyre politike është e lidhur me lirinë e zgjedhjeve, me lirinë e votës. Nëse populli do t'i vlerësojë për atë që po bëjnë apo për çfarë mund të bëjnë, mund të kenë ndonjë shans nesër në politikë. Nëse populli nuk do t'i vlerësojë, po jo ky populli sot, por populli i çliruar nga kryetarët e partive tuaja....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetar, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti ke folur shumë më tepër sot këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot është më mirë të dëgjosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke ftuar popullin për ta dëgjuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian, edhe atë ditë që fola atje, bëre të njëjtën gjë. Unë nuk kam nevojë të flas, sepse kam shumë vende ku mund të flas, po ti ke nevojë të dëgjosh. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Për të mbrojtur integritetin e komisionit, sepse këtu u bënë deklarata, do të thosha se vërtet ju keni pikëpamjet tuaja politike për Republikën e Shqipërisë apo si janë gjërat, kjo është e drejta juaj, sepse, në fund të fundit, jeni parti politike, por ky komision dhe ky Kuvend e ka tagrin për të miratuar reformën zgjedhore. Vokacioni juaj në këtë sallë është në themel të asaj që ne thamë, që kemi vullnet për t’i dëgjuar të gjithë. Fatkeqësisht, nuk bëhemi dot në një mendje, as nuk i shkruajmë dot ligjet si në venomet e krahinës nga vjet ti apo unë, apo nga ndonjë Kuvend në Greqinë e Lashtë. Ligjet i shkruan dhe i miraton një Kuvend, i cili zgjidhet nga populli. Kjo është baza e demokracisë, sepse nuk do t’i shkruajmë ligje në mitingje me popullin. Duhet t’i dëgjojmë të gjithë.

Ju folët dhe keni pikëpamjen tuaj, të cilën nuk dua ta kundërshtoj dhe as ta mbështes. Çështja e sistemit do të trajtohet dhe natyrshëm vokacioni juaj do të jetë publik dhe jam i bindur që do të kesh qëndrimin tënd. T’i lëmë ofendimet dhe paragjykimet. Ne jemi të gjithë aktorë politikë, secili ka interesat e veta racionale. Në fund të fundit, le të respektojmë punën e këtij komisioni dhe të vlerësohet fakti që po bëjmë një seancë transparente, pavarësisht nëse dikush di ta përdorë këtë seancë, dhe dikush tjetër dëshiron thjesht të bëjë zhurmë.

Zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Të them të drejtën, zoti kryetar, unë jo vetëm që nuk u ndjeva i ofenduar, por për herë të parë pas rënies së komunizmit, si ish-student i dhjetorit, në 29 vjet, jam 100% dakord me ju, edhe pse nuk kam qenë politikisht dakord në vitin 1990. Nuk i shtoj dhe nuk i heq asnjë presje asaj çfarë u tha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk kam qenë në vitin 1990. Kam qenë kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pse për të përmbysur Koçon u ngrita në ‘90?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, madje nga muaji prill i vitit 2008, zoti Fino.

Meqë Damiani thotë se ligjet i bën ky parlament në emër të popullit, ky parlament, Damian, nuk është i popullit që prej tre palë zgjedhjeve, por është i kryetarëve të partive. Deputetët nuk janë deputetë, por janë punëtorë të partisë në Kuvendin e Shqipërisë, Damian.

E pranoj kur tha: nuk jeni të lirë. Ju nuk jeni të lirë. Këta këtej i kanë dhënë provat se janë rebelë në shpirt, sepse nuk iu bindën Enverit numër 1, por as “Enver Kryemadhit”, as “Enver Bashës”. Ju jeni bindur 100% dhe vazhdoi t’i bindeni “Enver Ramës”, meqë jemi në ish-zyrën e Enverit. Pra, ndryshimi i sistemit është qelbi që kjo plagë..., pra nuk bëhet me gjethe tavlle kjo plagë, Damian, por duhet shtrydhur. Nëse nuk e shtrydhim plagën, do të plasë në vend tjetër. Absolutisht, shqiptarët duhet ta dinë për kë votojnë, sepse ne që bëjmë ligje, nuk duhet të jemi hipokritë; duhet të flasim në emër të shqiptarëve, të bëjmë ligje në emër të shqiptarëve, dhe që të mbrojmë interesat e shqiptarëve duhet të zgjidhemi nga votat e shqiptarëve, jo sepse i do qejfi Lul Bashës apo Edi Ramës sot, dhe Sali Berishës e Edi Ramën dje. Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më thuaj, cili qytetar e di se kë ka deputet të vetin sot? Më gjej një qytetar.

Ti, Damian, deputet i cilëve qytetarë je?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk jam unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam qenë deputet i qytetarëve me babanë tënd, ndjesë pastë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dil jashtë kupolës së kryetarit dhe linçoje një fjalë të vetme. Unë jam dakord me ty. Unë vij me qejf te maxhoritari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë i kam kaluar një palë zgjedhje, Damian.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian, unë personalisht kam qenë deputet në sistemin maxhoritar me babanë tënd në vitin 1997 dhe e njoh mirë rëndësinë e votës së qytetarit. Kam qenë rebel në vitet 2001-2005, sepse m’i keni vjedhur votat. Unë po ta kërkoj. Kurrë mos u bëfsha deputet! Ju keni hallin e karriges së deputetit. Unë nuk dua të jem deputet. Unë dua që qytetarët shqiptarë të mos merren nëpër këmbë nga dy individë birbo, që erdhën pas 15 vjetëve, duke grumbulluar kazanët e plehrave të BE-së, që, për fatin e keq të shqiptarëve, të dy ato vende të BE-së vendosën veton për të mos i hapur negociatat Shqipërisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Blerina Gjylameti - Më falni, zoti Bashkim, ju lutem!

E falënderojmë zotin Kokëdhima për mendimin e tij. Zoti Murrizi, do t'ju lutesha, të respektojme maksimalisht qoftë vendimin tuaj për të mos djegur mandatet, dhe besoj se këtë e kemi treguar. Kjo tregon një hap shumë të rëndësishëm në demokracinë e këtij vendi për mirëfunksionimin, por do t'ju lutesha...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju ndërpreva asnjë sekondë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjo!

Do t'ju lutesha në të njëjtën mënyrë të na respektonit për lirinë tonë dhe për të rregulluar vullnetin tonë në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni qenë deputet kur ka pasur një sistem maxhoritar ndryshe, unë nuk kam qenë. Kam qenë deputete liste, vazhdoj të jem deputete liste. Nesër, nëse biem dakord të gjithë bashkë për ta ndryshuar, mund të jem në maxhoritar apo në proporcional, por një gjë nuk duhet të na mungojë asnjërit prej nesh në këtë tryezë, respekti për njëri-tjetrit. Ju lutem, jini më të kujdesshëm!

Së pari, ne përfaqësojmë ata qytetarë.

Ju lutem, të jemi shumë të kujdesshëm në mënyrën se si i drejtohem njëri-tjetrit. Nëse ne nuk gjejmë një gjuhë këtu, kë përfaqësojmë ne? Çfarë rëndësie ka sistemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sistemi nuk ka rëndësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Murrizi, nuk ju ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi sistemi. Rëndësi ka mënyra si i drejtohem njëri-tjetrit, të mos fyejmë dhe të mos cenojmë. Ju mendoni se jeni i lirë. Unë po ju them se jam shumë më e lirë sesa ju për të vendosur nëse ky sistem mund të ndryshohet apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkë kemi thënë që të vini me një propozim për ta diskutuar së bashku. Unë këtë dua të shikoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri - Zoti Koço, faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Abazi – Ju falënderoj!

Do të flas shumë shkurt.

Së pari, dua t'ju them dy bashkëkryetarëve sikur të na tregonit si keni menduar ta ndani këtë reformë gjithëpërfshirëse në 2, 3, 4, 5 pjesë? Unë jam përgatitur vetëm për pjesën e parë, të cilën na e keni sjellë me draft. Besova se në fillim do ta menaxhonit, siç thatë, që do t'ua ndërprisnit fjalën atyre që do të dilnin nga tema, por ju rrëshqiti nga duart. Gjithsesi, kjo për mua nuk është korrekte.

Së dyti, duhet të jemi të gjithë pjesë e kësaj, sepse deri në tetor të vitit 2018 ne kemi marrë drafte nga bashkëkryetarët e komisioneve e të dyja palëve, kur ishte pjesë edhe PD-ja, madje unë i ruaj me fanatizëm draftet me idenë që një nga këto do të futen për të rregulluar disa elemente të sistemimit, por po zhgënjehemi, sepse gjërat po ndërrohen në mënyrë shumë të çuditshme.

Së treti, kjo do të na ndihmonte edhe ne të ishim racionalë për diskutimet që do të sjellim.

Kam një vërejtje për të gjithë. Unë kam drejtuar tryezën e partive politike për problemet zgjedhore mbi tre vjet e gjysmë, ku kemi bërë takime informale dhe në takimet formale ju garantoj se i kemi bërë shumë dinjitoze, duke dëgjuar njëri-tjetrin dhe pas çdo takimi kemi dalë me rezoluta, duke i konfirmuar secili nga ne, dhe jua kemi përcjellë në Kuvend. Po çuditëm që nënkryetari i parlamentit thotë që nuk ka asnjë gjurmë të draftit që ne i kemi çuar përmes një nisme ligjore.

Lidhur me shoqërinë civile, që të gjithë e duam dhe e vlerësojmë, është e disata herë që vjen në takime të tilla, flet, sepse natyrisht ka gjëra që janë për t'u dëgjuar, dhe dalin përjashta, pa na dëgjuar ne nëse kemi mendime, apo nëse mendimet e tyre vlejnë.

Lidhur me draftin që na keni sjellë, për të qenë konkretë, në nenin 3, pika 4, në pikën e parë, rreshti i tretë thuhet: “deri në ditën e zgjedhjeve”, ne, subjekte politike që kemi hyrë në zgjedhje e kemi vuajtur këtë dhe ua them me shpirt, por dita e zgjedhjeve është dita e votimit, atë natë fillojnë proceset dhe vazhdojnë 1 ditë, 2, 3, 4, 5 deri në një javë mund të shkojë, a nuk hyjnë te shpenzimet këto ditë ose këto aktivitete?

Për problemin e medieve, që e kemi prekur dhe u morëm shumë gjatë me të, i cili lidhet me financimin, në të gjitha kërkesat tona në kemi kërkuar që media duhet të financohet dhe duhet të jetë një dritare. Para dy vjetësh u miratua një ligj në parlament me shumicë të cilësuar, por nga KQZ-ja na erdhi një vendim, ku thuhej se anulohet vendimi i Kuvendit dhe përsëri subjektet politike nuk kanë akses në medie. Unë nuk e di sesi do të rregullohet kjo,

sepse edhe ne duam të artikulojmë mendimet që kemi, jo aq të vyera sa tuajat, por duam t'ua themi mbështetësve tanë.

Në pikën 3 të nenit 7, midis të tjerave, ju thoni: “Bën një deklaratë me nënshkrim, i cili, kryetari i partisë, angazhohet në mënyrë solemne”. Pse duhet të themi që angazhohet në mënyrë solemne, ku ne mund ta themi shumë bukur që ai duhet të deklarojë se e njuh ligjin, detyrimet që dalin prej tij dhe do të jetë i detyruar ta zbatojë pikë për pikë gjatë të gjithë kohës së fushatës zgjedhore nga momenti që dekretohen zgjedhjet.

Neni 8, që keni në vijim, është në interferim me nenin 3/1 që keni përpara, ku thuhet “Barazia gjinore”. Jam shumë dakord që e keni specifikuar dhe i keni dhënë akses, sepse ky nen ka rregulluar frymëmarrjen dhe marrëdhënien mes njerëzve, por e mbivendosni përsëri në nenin 8, ndërkohë që në nenin 3/1 është e përfshirë mënyra sesi do të jetë renditja, sa do të jenë raportet e të tjerë.

Neni 9 nis me disa nënshkrime. Kjo mund të jetë pjesë e sistemit, por nuk e di nëse do të jetë edhe pjesë e Kodit. Ky nen lidhet me regjistrimin e subjekteve politike. Ne, që të mos them qajmë, por strapacohemi, ose çdo kandidat dhe subjekt politik starpacohet kur vjen koha e zgjedhjeve. Këtu thuhet nënshkrimet dhe ne ua kemi dhënë shembullin e Italinë, e cila ka një prag 300-500 vota dhe ne mund ta bëjmë 500; ajo ka një prag për koalicionet 700 dhe ne ta bëjmë 1000. Për t'u futur në garë përsëri me ato nivele të kalimit të pragut do të vazhdojmë, sepse ne në Kod kemi lista të hapura dhe të mbyllura? Por ne nuk mund të futemi në garë kur është shpallur nga Presidenti apo parlamenti data e zgjedhjeve. Pse ndodh kjo?! Sepse, edhe sikur të bëjmë listat, dalin komisione pas komisionesh dhe verifikojnë nëse ishte emri i babait i saktë apo kishte një shkronjë mangët.

Në nenin 10 përsëri ka një ndryshim, sepse thuhet: “Subjekteve zgjedhore u ndalohet...”, por meqenëse e kam parë me shumë vëmendje, unë mendoj se ka disa gjëra që duhen korrigjuar, të cilat lidhen me nenin 7.

Vazhdojmë me një pikë tjetër, që unë gjykoj se te shuma e përllogaritur te neni 14, jam plotësisht dakord me të gjitha masat dhe parashikimet që keni bërë për problemin e financimit. Unë jam dakord që të bëhet transparenca dhe të merren të gjitha masat, sepse, në fund të fundit, të gjithë shqiptarët duhet ta marrin vesh se ku shkojnë paratë e taksapaguesve dhe ta kuptojnë se kush nga “oligarkët” janë ata që sponsorizojnë herë pas here fushatat zgjedhore. Kjo duhet parë, sepse thuhet se shuma e përllogaritur, e cila sipas nenit x, në shpenzimet e raportuara nga partia apo subjekti dhe pastaj kalon me vlerësimin e auditimit ose të ekspertëve që shkojnë nga KQZ-ja. Mendoj se ky paragraf duhet rregulluar.

Neni 19. Unë nuk e kuptoj, por po e lexoj, sepse mund ta kuptoni ju, ku thuhet “Shuma e shpenzimeve të bëra nga një parti politike, përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore, nuk duhet të jetë më shumë se dy herë më e madhe se shumata më e lartë që kanë...”. Kjo është një lëmsh shprehjesh dhe unë mendoj se mund të bëhet kështu: “Shuma e shpenzimeve të bëra nga subjekti duhet të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës që subjekti përfiton nga ajo”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jua kam sjell me shkrim, sepse ato që kam sjellë më parë i kanë hedhur në kosh të plehrave.

Nëse do të arrini që financimi të bëhet me një kosto pak të sforcuar, ose ashtu si ta gjykoni nga buxheti i shtetit, por të jenë të kontrolluara dhe pikat që përmendni ju, që 24 orë përpara duhet të planifikohen, të raportohen dhe të ndiqen spermës situacioneve, do të jetë një risi që do të shpëtoni nga kjo.

Së fundi, na thoni programin se si do të përgatitemi për temat që ju do të ndani dhe të mos hallakatem me të tjerat, sepse humbasim kohën dhe durimin.

Ju faleminderit!

Damian Gjikhuri- Këtu ke të drejtë dhe kërkoj ndjesë, sepse është përgjegjësi imja që të ftuarit nuk duhet të dilnin jashtë rendit të ditës, por, fatkeqësisht, transparenca dhe pjesëmarrja e tepërt e ka edhe këtë kosto dhe njerëzit përgjithësisht dalin jashtë teme.

A ka përfaqësues të tjerë, të cilët kanë qenë pjesë e kësaj liste?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga cila parti je?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një listë, sepse jo të gjitha partitë ftohen.

Valentin Mustaka- Unë jam Valentin Mustaka, kryetar i Partisë ABDE, ose e arumunëve të Shqipërisë. Këtë prezantim e kam bërë edhe para dy muajsh.

Unë jam shumë dakord që i zhvillon këto bisedime, por para dy vjetësh unë i kam bërë një letër këshilltarit Hahn në Këshillin e Europës dhe më ka kthyer një përgjigje: “Zoti Mustaka, mos u mërzit, sepse qeverisë shqiptare i kemi vënë 5 kushte për të hyrë në Europë, ku një nga këto kushte janë minoritetet”. Po të doni, kur të takohemi herën tjetër mund t’jua sjell. Mua më erdhi shumë keq që në këtë draft nuk përmendet fare emri ynë, por më e keqja është se edhe shoqëria civile, që unë i mbaj *pulito*, njerëz të pastër, nuk thonë asgjë për minoritetet, ku pjesë e saj mund të jenë edhe pjesëtarë të minoriteteve. Krahas këtij drafti, që nuk është vënë asgjë, unë them se duhet të shikojmë disa pika për minoritetet, sepse kur

diskutohet për minoritetet, unë e shoh sikur janë disa ferra që ju ngatërrojnë këmbët, por ne nuk jemi ferra që t'ju ngatërrojmë këmbët juve. Si e majta, ashtu edhe e djathta nuk flasin për minoritetet dhe ju dukemi sikur jemi ufo, që kemi ardhur rastësisht në këtë sallë, por ne jemi 9 minoritete në Shqipëri. Unë jua thashë edhe herën e kaluar, në parlamentin e Kosovës dëgjova 6 gjuhë të huaja dhe thashë që nuk duam 6 gjuhë të huaja, sepse me një dhe nuk merremi vesh. Ju më bëtë pyetje: “Zotëri, çfarë je ti?”, sepse edhe juve ju duka si ufo, pavarësisht se fola edhe herën e shkuar. Unë mendoj se te drafti i atij neni duhet të gjeni një nënkapitull për minoritetet. E them këtë, sepse duhet të planifikohen fonde të veçanta për minoritetet. Kjo nuk duhet të bazohet në disa censuse kot që janë bërë.

Së dyti, për kalimin e pragut zgjedhor, këto fonde duhet të kthehen mbrapsht, nëse nuk merren votat që duhen. Për minoritetet duhet të bëhet një përjashtim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të hiqet për minoritetet kjo pjesa për kthimin e lekëve kur nuk e kalojnë pragun. Po të shikoni shtetin gjerman ose atë polak, minoritetet nuk kthejnë asnjë lek.

E treta, në fushatat zgjedhore për partitë minoritare duhet të ketë specifika të veçanta, sepse ne, kur bëjmë fushatën, e bëjmë në gjuhën tonë dhe jo në gjuhën shqipe. Janë 9 minoritete që flasin 9 gjuhë të ndryshme. Ne kemi më shumë shpenzime se ata që flasin gjuhën shqipe. Prandaj në fushatat zgjedhore duhet që për minoritetet të caktohen fonde të veçanta.

Në përgjithësi, nuk mund të them më shumë fjalë për draftin, sepse nuk jemi ne ata që e përcaktojmë atë, sepse ne jemi minoritete, pra duke u nisur thjesht nga fjala, ne jemi pakicë. Janë shumë njerëz të tjerë që diskutojnë dhe ne jemi dakord me diskutimet e tyre. Duhet të keni parasysh që në draft duhet një pikë për minoritetet. Unë ju them, se nuk përtoj për të shkruar letra. I shkruaj përsëri unë atij... Ka ikur ai Hahn-i, por ka shkruar një Hahn tjetër atje dhe do t'ju detyrojë ai që minoriteteve t'u jepni vendin e duhur.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjicknuri – Zoti Murrizi, ju lutem!

Faleminderit për vlerësimet tuaja!

(Zoti Murrizi ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Murrizi, lërimi këto biseda për t'i bërë jashtë! Ajo që thatë është shumë interesante, por Kushtetua e Shqipërisë nuk i njeh partitë minoritare. Ajo që thatë, zoti Murrizi, duhet të shikohet nga pikëpamja sociale, pra këtu është parimi “*Converse*”, pra

minoritetet kanë pozita aq të forta në paritë politike, sa praktikisht kanë përfaqësim më të madh se të tjerat. Kjo është një gjë shumë e mirë. Megjithatë, Kushtetuta e Shqipërisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diskutimi yt është shumë interesant, por duhet propozim kushtetues që Shqipëria t'i lejojë partitë etnike.

Urdhëroni!

Gjovalin Shqalshi – Gjovalin Shqalshi, kryetar i Partisë së Personave me Aftësi të Kufizuara të Shqipërisë. Dua ta nis me një mikro vërejtje për përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët i dëgjova me shumë vëmendje, sepse ishin thirrur për të dhënë mend, por asnjëri nuk e nisi nga Karta e të Drejtave të Njeriut, që është rregullatori më i mirë i shoqërive demokratike botërore. E para kjo.

Së dyti, u diskutua “si të dënojmë hajdutin”, por askush nuk tha si ta kapim hajdutin. Pra, duhet kapur dhe dënuar hajduti i votave.

Së treti, Shqipëria ka 170 mijë persona me aftësi të kufizuara, 17 mijë invalidë pune, invalidë politikë dhe invalidë lufte, të cilët në 30 vjet demokraci nuk kanë pasur asnjëlloj përfaqësimi.

Për këtë çështje unë u kam bërë disa kërkesa aktorëve politikë në Shqipëri. Kam kërkuar që ne të kemi përfaqësuesit tanë në komisionet zgjedhore, në komisionin e bërjes së ligjit parazgjedhor ku dhe të sanksionohet që ne të mos kemi as barriera, as kushte dhe as sanksione, për vetë formën e jetesës që kemi.

Më kryesorja, ndryshe nga të gjitha partitë politike shqiptare, ne asnjëherë nuk ju kemi kërkuar karrige, tenderë, ambasada, makina dhe as televizione private. Ne kërkojmë përfaqësim politik, zotërinj. Kërkojmë që në këshillat bashkiakë të kemi nga një përfaqësues.

Për ta mbyllur, po ju sjell një shembull. Shkova për të hapur një numër llogarie në një bankë, ku më thatë bravo që keni sot përfaqësues për t'u futur në këshillat bashkiakë se 100 herë ua kanë lëvizur datat e pensioneve invalidëve të punës, luftës dhe atyre politikë. Lëvizin datat e pensioneve, sepse aty nuk kemi përfaqësim politik.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – E dëgjova keq, apo thatë që keni 17 mijë invalidë lufte?

(Diskutim pa mikrofon)

Të gjithë bashkë. U habita, sepse që të kemi 17 mijë invalidë lufte, duhet të jenë 93 vjeç e sipër. Nuk i ka lista e votuesve 17 mijë njerëz të moshave 93, 94, 95 apo 96 vjeç.

(Diskutim pa mikrofon)

Për invalidë pune jam dakord me ty, por mendova se thatë invalidë lufte.

Mirilla Kondakçiu - Përshëndetje!

Quhem Mirilla Kondakçiu, avokat, përfaqësues i kandidatit të pavarur në qarkun Berat, Plarent Aleksi.

Faleminderit!

(Diskutim pa mikrofon)

Po pra, ai ka bërë propozimet e ...

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, jo...

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti kryetar, duke qenë se

(Diskutim pa mikrofon)

Duke qenë aktorë që kemi propozuar ...

(Diskutim pa mikrofon)

Po më duket vetja i tepërt.

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti kryetar, duke qenë se deri më sot demokracitë kanë prodhuar disa lloje sistemesh zgjedhore, shoqëria civile është e interesuar të ndërtojë sisteme zgjedhore në mënyrë që të ndalojë rrjedhjen e votave. Sot nuk mund të thuhet që iks sistem zgjedhor është më i mirë se tjetri. Të gjitha sistemet zgjedhore janë demokratike. E vetja gjë që na mbetet të themi është se nuk ekziston një sistem zgjedhor më i mirë se tjetri.

(Diskutim pa mikrofon)

Ne i kemi nisur me shkrim, zoti kryetar, por po jua them shkurtimisht. Në projektligjin që na keni dërguar ju thoni që në nenin 44 të shfuqizohet germa “c”, kurse ne mendojmë që duhet të qëndrojë sipas kodit aktual. Te kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve, thuhet që të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar. Në momentin që ju e hiqni këtë dispozitë, personave që janë shpallur me vendim gjyqësor, që ju hiqet zotësia për të vepruar, u lind e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje. Këta barazohen me personat që nuk kanë mbushur moshën për të votuar dhe që nuk kanë zotësi për të vepruar. Pra, kjo është gabim. Mendojmë që germa “c” duhet të qëndrojë. Gjithashtu, mendojmë që të shtohet germa “e”, që personat që vuajnë dënimin penal të mos kenë të drejtë vote. Propozimet tona i kemi dërguar me shkrim, ku ka shumë gjëra, të cilat kërkojmë të merren në konsideratë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjicknuri – Atëherë, sot i mbyllim ...

Përfaqësues partie jeni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë!

Gjergj Prifti – Përshëndetje!

Në fakt sot duhet ta fillonim aty ku sistemi çalon me të vërtetë, te numërimi i votave.

Për mendimin tonë, ky është elementi kryesor me të cilin duhet të fillojë edhe ndryshimi i Kodit Zgjedhor. Nuk mundet që votat të numërohen përsëri nga partitë politike, pasi populli e ka humbur besimin te procesi i numërimit të votave dhe te rezultati.

Në fakt, takimi i sotëm duhet të na vendoste në një moment reflektimi, duke na qartësuar imazhin që propozimet për ndryshime në Kodin Zgjedhor të paktën një herë të vetme të dalin nga zyra e Kuvendit, ku jemi sot, dhe të diskutohen në një tryezë gjithëpërfshirëse, ashtu siç tha edhe zoti Kume.

Kemi dëgjuar shpesh të flasim për një kod të gabuar, sepse kodi që kemi tani, kodi spanjoll, nuk përshtatet ashtu siç duhet dhe kemi nevojë për disa shtesa nga një kod gjerman apo francez. Në të vërtetë të gjithë kodet që përmenda më sipër janë bërë në përshtatje me nevojat që kanë këto vende për të rregulluar mekanizmat me të cilat ato funksionojnë. Në asnjë nga këto vende nuk do t'i shkonte kujt në mendje që ministri i rendit do të kishte një vëllë trafikant apo më keq akoma, ministri para tij të ishte vetë i përfshirë në trafikun e drogës.

(Diskutim pa mikrofon)

Ne duhet ta diskutojmë këtë.

(Diskutim pa mikrofon)

Një sekondë.

Apo personi që pretendon të bëhet Kryeministër nesër të ketë urdhëruar vrasjen e popullit të tij. Këto janë realitete. Apo jo? Prandaj, ne mendojmë që duhet një kod shqiptar, i thjeshtë.

(Diskutim pa mikrofon)

Mund të qeshësh sa të duash, por unë mendoj që na duhet një kod vetëm për shqiptarët.

(Diskutim pa mikrofon)

Duhet një kod i përshtatshëm për ne. Të mos marrim kode nga vende të tjera dhe t'i përshtatim me Shqipërinë. Kodi zgjedhor duhet të jetë një mekanizëm që reflekton dhe i shërben demokratizimit të jetës politike të vendit, ku qytetarit t'i garantohet vota dhe

mostjetërsimi i saj. Nëse duhet të ndryshojmë diçka, ashtu siç thashë, është pengesa që ne kemi për të pasur një kod gjithëpërfshirës dhe demokratik.

Prandaj, LIBRA propozon që ndryshimet në Kodin Zgjedhor, siç e thashë edhe më parë, duhet të fokusohen te numërimi i votave, ku hajduti i votave të mos ketë më akses, pra, ku triada, PD, PS dhe LSI, të mos përfshihet më në numërimin e votave.

Ndërkohë shikojmë që nenet 68, 69, 70 vazhdojnë të persekutojnë partitë e vogla ose partitë që nuk janë në parlament. Ne duhet të sigurojmë, ashtu siç tha edhe zoti Abazi, 5 mijë nënshkrime për të marrë pjesë në zgjedhjet për kuvend dhe rreth 35 mijë nënshkrime të tjera për zgjedhjet vendore.

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, jo, nuk na futën. Na nxorën rrugëve për të mbledhur nënshkrime. Për të hyrë në zgjedhjet vendore na duhen nënshkrime sa për të krijuar 12 parti të reja. Kjo është absurde.

Prandaj, kjo pikë e kodit duhet parë dhe duhet vlerësuar. Ashtu siç tha edhe zoti Abazi, të shkojmë te 500 vota për parti dhe 700 vota për koalicionet.

Neni 71, pika 2, kërkon në vetvete identifikimin, me të padrejtë, të mbështetësve ose të nënshkruesve. Siç e dimë, mbështetësi i një force politike ka të drejtë kushtetuese të jetë i fshehur, kurse ne i kërkojmë nënshkruesit, përveç të dhënave, edhe kartën e identitetit. Pra, i kërkojmë çdolloj informacioni që, në fakt, në bazë të Kushtetutës duhet te jetë i fshehtë.

Për këtë arsye, ne kërkojmë që nga neni 2, paragrafi i dytë, të hiqet mbledhja e informacioneve konfidenciale, siç është karta e identitetit e të tjera.

Rudina Hajdari – Mund ta përmbliidhni fjalën, sepse ju kemi lënë goxha kohë në dispozicion. Ka pasur përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, të cilëve jemi detyruar t'ua ndërpresim fjalën.

(Diskutim pa mikrofon)

Gjergj Prifti – Pra, LIBRA kërkon që të kalojmë në numërim elektronik, kjo për të siguruar votën. Njëkohësisht, kërkojmë depolitizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sepse kemi komisionerë partiakë. Kërkojmë që numërimi i votave të bëhet në qendrën e votimit, pra kutitë të mos shkojnë nga qendra e votimit në një zyrë qendrore për numërim.

Rudina Hajdari – Kjo nuk është në draftin paraprak, është në draftin tjetër. Të jemi konkretë.

Gjergj Prifti – Askush nuk foli për financime. Të gjithë folën për sistemin, kështu që edhe ne kemi të drejtë të flasim për sistemin.

Rudina Hajdari – Do të ketë edhe një draft tjetër, që po përgatitet nga ekspertët, për të cilin do të vini përsëri të jepni mendimet tuaja.

Gjergj Prifti – Po na thirrët përsëri, sepse këtu është problemi.

(Diskutim pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Ke hapur tema shumë të rëndësishme, sidomos për çështje të administrimit zgjedhor, që natyrshëm ne do të bëjmë një aktivitet tjetër, ku të gjithë pjesëmarrësit do të jenë të ftuar.

Para se ta mbyll dua t’ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen!

Kjo ishte një seancë shumë transparente, ku mbase e kemi tejkaluar edhe rendin e ditës, shpeshherë edhe kohën, por, në fund të fundit, le ta bëjmë këtë sakrificë për hir të transparencës, pasi reforma nuk është e kësaj salle, por e të gjithë Shqiptarëve.

Së fundi, dua ta mbyll duke ju njoftuar që mbledhjen e radhës të Komisionit të Reformës Zgjedhore do ta zhvillojmë ditën e enjte në orën 10:00 (ramë dakord me bashkëkryetaren), ku ekspertët do të sjellin draftin tjetër për sa u përket çështjeve të administrimit zgjedhor. Pas diskutimeve në komision do të zhvillojmë përsëri një raund tjetër konsultimesh në mënyrë që gjërat të jenë transparente.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

